

Jung

Agron Bajraktari

KREU 1

Emri im është Jung. Origjina e këtij emri rrjedh pikërisht nga ajo që jeni duke menduar, nga psikiatri zviceran Karl G. Jung, i cili, sipas gojëdhënave të babait tim, arriti ta shpëtojë të gjallë nga lufta. Jung, thoshte babai, e kishte pranuar si një nga tetëdhjetë mijë pacientët e tij dhe, nëpërmjet shpjegimit të një ëndrrë që im atë kishte parë, kishte qenë i aftë t'i shpëtonte jetën. Detajet e kësaj ndodhie më vijnë si të vakëta tani, por mbaj mend mamane time, që në përpjekje për të shpjeguar kuriozitetin tim fëmënor më thoshte se isha ngjizur sapo babai kishte ardhur nga lufta dhe që unë, siç edhe ai e thoshte me krenari, isha triumfi i jetës mbi vdekjen. Jam i sigurt që e ka pasur fjalën më shumë për vdekjen e tij sesa vdekjen në përgjithësi, por, si produkt i një betimi kur lufta kishte mbaruar, emri i djalit të tij do të ishte i njëjtë me emrin e atij që i kishte shpëtuar jetën. Pra ky jam unë, Jungu.

T'ju them të drejtën kam qenë përherë skeptik në lidhje me këtë histori. Jam natyrë dyshuese dhe të tilla histori, të cilat në pamje të parë, shpeshherë dhe në të dytën, të japin një ndjesi misticizmi, më bëjnë të ndiej keqardhje për ata që i besojnë. Por përtej kësaj, kur kujtoj qëndrimin e babait teksa tregonte këtë ndodhi, shkëlqimin në sytë e tij, shpatullat e tërhequra mbrapa, që tregonin krenarinë ushtarake të cilën nuk e kishte harruar as pas tërë atyre viteve në pension, një pjesë e asaj gjëje që unë quaja iluzion prekte kuriozitetin për t'u futur më thellë në domethëniet e tij të vërteta.

Vitet kaluan dhe kurioziteti filloi të humbiste nën shtresat e interesave të reja. Ishte semestri i dytë që studioja për shkenca kompjuterike dhe, ngaqë semestri i parë kishte kaluar pa u ndier, më shumë si pasojë e entuziazmit për diçka të re sesa për një dashuri që vetëm shtoej, i dyti më gjeti të lodhur nga mënyra se si po shkonte ai interes.

Gjithë këtë punën e interesave që lindin dhe vdesin brenda një periudhe të shkurtër e shoh si ngjyrën e verdhë të gjetheve të vjeshtës. Është diçka mahnitëse, por pastaj vjeshta ikën për t'i lënë vendin dimrit, e pavarësisht pse përjetësia është një ide që e përçmoj, sepse asgjë nuk është aq e shumëllojshme sa të mbushë pafundësinë me gjë tjetër veç mërziisë, ajo që unë dua është një verë e përjetshme. Por nëse gjethet e verdha do të zgjasnin për dy stinë, dashuria ime për to do të zgjaste dhe më pak. Jo çdo dashuri ka të bëjë me ditët apo vitet që zgjat. Me disa ndodh e kundërta, sa më pak orë, aq më intensive dashuria.

I tillë ishte dhe flirti im me shkencën. Më shijonte vetëdija që shkenca ishte arsyeja e zgjatjes së jetës së njeriut, mirëqenies së tij dhe të gjitha shpikjeve që përdornim çdo ditë, por ta studioje ishte diçka ndryshe. Ngaqë nuk ndihesha i plotësuar, interesi im kishte rënë pak nga pak drejt një indifference totale ndaj jetës universitare.

Lejomëni të them dhe këtë tjetrën, sepse jo i gjithë faji bie mbi shpatullat e mia. Pikësëpari, ideja të studioja këtë degë nuk ishte e tëra zgjidhja ime, sepse të gjithë familjarët më kishin motivuar drejt saj. Është diçka e çuditshme kjo puna e motivimit. Një zjarr ndizet brenda teje dhe ti mendon se është zjarri yt, por duhet të kalojë pakëz kohë të kuptosh se në fakt ai është zjarri i të gjithë njerëzve që kanë fryrë mbi ty. Është iluzion që kthehet në realitet të frikshëm, nëse nuk e kupton në kohë mashtrimin që i ke bërë vetes.

Atë ditë isha ulur në kafenenë time të preferuar. Qielli ishte i kthjellët dhe dielli rrezatonte fuqishëm. Ishin të rralla ditët kur ai shkëlqente në atë mënyrë në dhjetor, por kur dilte shihje njerëz tek zhvisheshin nga zymtësia që i kishte kapluar, e tek-tuk ndonjë lehtësonte veshjen.

Por ajo ishte një ditë jave dhe ndodhitë që përmenda më sipër ndodhnin zakonisht nëpër fundjava. Sepse, nëse shihje me vëmendje, dukej sikur njerëzit

jetonin vetëm fundjavave. Sikur e gjithë java ishte një tregues i qëndrueshmërisë së tyre ndaj fatit që u kishte vendosur jeta dhe fundjava ishte shpërblimi i tyre. Të kalosh pesë ditë në pritje të dy ditëve? Ishte diçka që nuk mund t'ia toleroja vetes. Nuk mund t'ia toleroja as babait, i cili, nëse do e merrte vesh që pak nga pak po tërhiqesha nga studimet, do të bënte namin e pastaj sigurisht do të fillonte me ndonjë nga ato historitë e tij të zakonshme të luftës, se si kishte luftuar për familjen, se si unë isha në borxh me të, se si jeta nuk ishte një fushë me lule etj. etj. Fjalimet e zakonshme të prindërve, më kuptoni besoj.

Dhe ja tek ishte, manifestimi i plotë i kryeneçësisë, i ulur në një kafene priste t'i ulej në karrigen përballë përgjigja e pyetjes që ende nuk e dinte. Por kjo ndodhte vetëm nëpër filma, sepse në jetën reale në karrigen kundruall meje u ul banakieri i kafenesë.

- Pushim sot, ë? - m'u drejtua ai me një shikim tinëzar.
- Pushim, - ia ktheva unë duke mos i kushtuar shumë vëmendje.

Baroni ishte rreth të dyzetave. Të linte përshtypjen e mashkullit që edhe tetëdhjetë vjeç nuk do të reshte kurrë pa ua hedhur sytë dhe pa i lakmuar femrat më të reja se ai. Ishte qeros, por kishte sharmë dhe durim të atillë, që asnjë femër, pavarësisht moshës, nuk mund ta shmangte.

- E ke parë atë zoçkën atje? - tha ai duke bërë me kokë nga mbrapa.
- Jo, - i përgjigjem unë duke ngritur sytë.

Hodha një shikim të shpejtë dhe ajo që pashë më bëri ta ngrija kokën përsëri. Gjysma e fytyrës së saj ishte e humbur pas një libri, por munda t'ia shoh sytë. Ngjyra e tyre ishte diçka e papërcaktueshme nga ajo distancë dhe më jepte një ndjesi kurioziteti që duhej ta shuaja se s'bën, ose diçka brenda meje do të

vdiste. Flokët i kishte të kuq dhe nën rrezet e diellit koka dukej sikur i kishte marrë flakë.

Për një moment sytë e saj u ndeshën me të mitë dhe unë, si hajduti kur zihet në flagrancë, tërhoqa shikimin zvarrë drejt fytyrës së Baronit.

- Të dogji, ë? - ia bëri ai.
- Ku dreqin e gjen dhe ti një humor të tiillë që në pikë të mëngjesit?
- Ç'pikë e mëngjesit ore! - ma ktheu ai i habitur. - Është të paktën dymbëdhjetë.

Hodha shikimin drejt orës, më shumë nga instinkti sesa nga mosbesimi, dhe pashë akrepat që godisnin orën dymbëdhjetë e dy minuta.

Ta hajë dreqi, shava me vete.

Në këtë orë zakonisht ndodhesha në bibliotekë. Shpresoj të mos jeni keqkuptuar kur fola në atë mënyrë për institucionet edukative. Kritika ime është ndaj pjesës së parë të emrit, jo të dytës. E thënë shkurt, më pëlqen të mësoj, jo të studioj.

Me t'u kujtuar, pagova kafënë, u përshëndeta me Baronin dhe u takova në hyrje me ajrin e freskët të asaj dite dhjetori.

Biblioteka ishte në një godinë të fshehur nga pamja e rrugës. Nuk ishte e madhe, por nuk ishte dhe aq e vogël sa të mos pranonte brenda dhjetëra rafte mbushur me inteligjencën e mijëra njerëzve gjatë mijëra viteve e që prisnin të paktën një shfletim nga dora e të gjallëve. Është interesante kjo puna e librave. Një njeri mund ta kalojë tërë jetën e tij në përpjekje për të përkthyer mendimet dhe emocionet në letër dhe në një moment tjetër, në një kohë tjetër, një tjetër njeri mund ta lexojë atë përpjekje brenda disa orëve. Nëse magjia ekziston, kjo është njëra prej tyre.

Interesi im anohej më shumë drejt librave filozofikë dhe atyre që përmbanin histori dystopike. Jam i bindur se njerëzit mund të mësojnë nga gabimet e tyre vetëm kur shohin pasoja mbi kurrizin e një qenieje tjetër, ose mbi veten, por në një periudhë tjetër kohore dhe me një përçudnim të realitetit në atë mënyrë, sa të mos këtë fare ngjashmëri me atë në të cilin ata jetojnë. Njeriu seç ka tabu gabimet që përsëriten mbi kurrizin e vet dhe liri mbi kritikën që krijohen mbi kurrizin e të tjerëve.

Para disa muajve isha përpjekur të krijoja një histori të shkurtër mbi efektet që injoranca shkencore ka mbi të ardhmen e jetës moderne siç ne e njohim. Ideja ishte të sillja apokalipsin e meteorit që kishte shfarosur dinozaurët në epokën kur njerëzit jetonin, por me një kleçkë. Në atë rrëfim njerëzit kishin kohë që ishin shfarosur dhe ishin dinozaurët ata që kishin krijuar teknologjinë të avancuar. Tregimin e mbyll me një shfarosje të dinozaurëve si pasojë e dështimit për t'i bindur qeveritë t'u jepnin fondet e mjaftueshme për të krijuar një pajisje për devijimin e trajektores së meteorit.

Gjithsesi, ky ishte një rrëfim që kishte kohë i lënë mënjane, duke e menduar thjesht si një tekë të momentit për të shprehur një ide, dhe nuk më kishte shkuar ndër mend ta zgjeroja më tej.

Zakonisht, në atë orë, biblioteka ishte e boshatisur. Ja përse nuk mund ta devijojë vesin tim drejt një orari tjetër. Më pëlqente të lexoja në qetësi. Sigurisht që bibliotekat janë të heshtura edhe kur ka njerëz në to, por ajo për të cilën e kam fjalën është një heshtje ndryshe, vakum nga të gjithë trupat njerëzorë përveç trupit tim.

Kjo siç duket ishte dëshirë që atë ditë nuk do mund të përmbushej, sepse nga larg dëgjova kërcitjen e përhershme të derës së ndryshkur të hyrjes. Kaluan mjaft minuta dhe shpresova që dikush të ishte larguar. Por shpresa u venit

kur papritur u shfaq hija e një njeriu që po kërkonte një libër në raftin përballë meje. Mes nesh qëndronte sektori i filozofisë.

Teksa po bëhesha gati t'i thosha të bënte më shumë kujdes me ndotjen akustike (them kujdes, jo si pasojë e një stereotipi, por si eksperiencia e qindra ditëve mungesë fryme mashkullore në bibliotekë), hija u shndërrua në formë mishi me flokë të kuqërremtë.

- Më falni! - m'u drejtua ajo, e tëra e skuqur. - Shpresoj të mos jua kem trazuar leximin.
- Jo, jo, nuk më bezdisët aspak.

Nuk mund të mos e gënjeja. Vështrimi i saj, që në kafene ishte shfaqur si një ngjyrë e papërcaktueshme, tani manifestohej me kthjelltësinë e mijëra qiejve. Nëse sytë janë me të vërtetë porta e shpirtit (apo çfarëdo gjëje tjetër), dera e shpirtit të saj u shfaq përpara meje krejtësisht e hapur.

Ajo u përkul të merrte librin që i kishte rënë në tokë dhe e mbështolli me dy duart e kryqëzuara mbi gjoks.

- Vjen shpesh? - më pyeti. - Nuk të kam parë këtu më parë.
- E çuditshme, - ia ktheva unë. - Vij pothuajse çdo ditë dhe është hera e parë që të shoh këtu.
- Ndoshta kemi orare të ndryshme.
- Ose thjesht fshihemi pas rafteve të ndryshme, - i them, duke treguar me gisht nga libri që kisha vendosur mbi tavolinë. - Tek shoh titullin e librit që ke në dorë, duket që raftet tona janë larg.
- Ah po, shkenca është mjaft larg raftit të filozofisë.
- Edhe pse e para ka lindur nga e dyta, - vazhdova unë dhe një buzëqeshje e lehtë i përshkoi sytë.

- Unë jam Baiba, - tha ajo dhe zgjati dorën drejt meje. U ngrita në këmbë dhe bëra të njëjtën gjë.
- Jung.
- Jung?!
- E pritshme. Nuk ka ndodhur ndonjëherë të prezantohem dhe të mos shpjegoj domethënien e emrit tim.
- Është emër i rëndë, duhet ta pranosh.
- Ndoshta prandaj nuk ndihem asnjëherë i lehtësuar pasi mbaroj së shpjeguari se përse im atë vendosi të më quante si psikanalisti zviceran.
- Vallë përse do ta bënte diçka të tillë babai yt?
- Kriza e moshës së mesme?!
- S'besoj së është gjë për t'u tallur. Me siguri e ka një arsye të fortë.
- Nëse një iluzion është një arsye e fortë, atëherë i tillë është.

Ia tregova origjinën ashtu siç ua tregova edhe juve dhe në fund gjithë ç'mora ishte një tundje e lehtë e kokës, që tregonte se sa interesant ishte ai shpjegim.

Është vetëm një drej emri, mendova me vete. Nuk supozohet të karakterizojë më shumë sesa identifikimin nga të tjerët.

Tavolina ku qëndroja ishte e ngjeshur pas murit, me nga një karrige në secilën anë. Baiba zuri karrigen përballë meje.

- E di se çfarë më mahniti më shumë nga shkenca? - pyeti ajo rrufeshëm, duke e paramenduar në njëfarë mënyre pyetjen që doja t'i bëja.
- Vërtetësia e saj?
- Pafundësia që ka zbuluar në natyrë! - vazhdoi, duke shmangur atë që thashë.
- Numrat. Yjet. Distanca mes tyre. Janë kaq të paperceptueshëm nga mendja jonë.

Është e imagjinueshme që ç'ke me të, mendova me vete. Eja njëherë te leksionet e profesor Shusmanit. Profesor Shusmani më jepte elektroteknikë. Elektriciteti më mahniste, por krijimi i qarqeve më vdiste. Këto mendime i mbajta për vete, ndërsa asaj i thashë:

- E dije që distanca mes atomeve të trupave tanë është më e madhe se ajo mes galaksive?
- E pamundur! - kërceu ajo me një shprehje habie dhe kundërshtimi përnjëherësh.
- Një fjalë që nuk supozohet të përmendet dhe aq shpesh nga seksioni i shkencave, apo jo?

Fytyra e saj iu kthye buzëqeshjes dhe aprovoi me një lëvizje të lehtë të kokës.

- Po ti, çfarë je duke lexuar?
- Një tregim të shkurtër mbi një shoqëri që ka arritur ëndrrën e perfeksionit.
- Arrihet diçka e tillë?
- S'e besoj. Më duket më shumë si iluzion.
- Përse?
- Nuk e di. Kështu e ndiej. Ndoshta i njoh njerëzit më shumë se ç'duhet.

Ajo pohoi përsëri me kokë dhe të dy ramë në heshtje.

Më duhet ta pranoj që po filloja të ndihesha rehat në shoqërinë e saj. E kam fjalën për atë llojin e rehatisë ku ndihesh aq mirë, sa je gati për të thënë gjëra që ke frikë t'ia thuash edhe vetes. Dukej sikur përreth saj sillej një aurë, e cila kur ndërthurej me timen, lirshmëria më kaplonte çdo ndjenjë e mendim dhe ndieja që në sytë e mi porta e shpirtit hapej, duke lejuar që ajo të shihte brenda meje. Ishte hera e dytë që ndieja diçka të tillë dhe ndoshta kjo ishte arsyeja se përse gjatë gjithë kohës ndihesha si në pezëm.

Nga buzëqeshja e shikimit të saj mund të thosha të njëjtën gjë dhe për të, por nuk mund të shpresoja për gjëra përtej aftësisë sime për t'i kuptuar. Shpresa është diçka tepër dredharake, që shpeshherë të krijon shenja që nuk janë aty dhe e prish punën pa filluar akoma.

Biseduam për disa minuta të tjera dhe pas një momenti të gjatë heshtjeje dhe sikleti, sepse asnjëri nuk dinte ç'të thoshte më, u përshëndetëm dhe iu kthyem asaj që po bënim në fillim. Përpara se të ikte munda të lexoj në sytë e saj një dëshirë për më shumë, për t'u takuar përsëri, ose ndoshta ai shikim mund të ketë qenë thjesht reflektimi i dëshirës sime, por diçka brenda meje më ndaloi ta bëja atë hap. E dija mjaft mirë burimin e asaj ndjesie e përsëri s'mund ta identifikoja të plotë. Ishte një mjegull nga e shkuara, që me tentakulat e saj të pangopura kërkonte të zotëronte edhe të ardhmen time.

KREU 2

Mora rrugën drejt apartamentit, por një mendim i ardhur nga asgjëja më bindi se kisha nevojë për shoqërinë e një fytyre të njohur.

Baroni më përshëndeti nga banaku me buzëqeshjen e tij të zakonshme. Nuk e kuptoja asnjëherë atë njeri. Dukej kaq enigmatik, por kur ulej dhe fillonte të fliste, çdo lloj ideje mbi misterin që mund ta rrethonte zhdukej sa hap e mbyll sytë. Disa mistere ekzistojnë vetëm sepse nuk kërkojmë mjaftueshëm. Dhe në rastin e Baronit kuptova se nuk kisha kërkuar mjaftueshëm.

U ula përballë tij dhe kurioziteti që i dergjej në sy e detyroi të më pyeste ende pa e përshëndetur.

- Si e le të ikte atë kokëkuqen, ë? Nuk të ndien gjë palca ty?

Tipike, mendova me vete.

- Në fakt, qëparë isha me të. E takova rastësisht në bibliotekë dhe biseduam një copë herë.

Fytyra e tij mori hijen e tinëzarit dhe filloi të lëvizte gishtin tregues lart e poshtë.

- E unë që mendoja se ishe qullac. - Dhe ia plasi të qeshurit.
- Pamja, Baron. Të gënjen.
- Njeriu gënjen, djalosh. Njeriu. Ajo që ai vendos t'i tregojë botës.
- Dhe sipas teje unë i treguakam botës paaftësi për të folur me një femër të bukur?!
- E ftove të takoheshit përsëri?
- Jo, - i them unë i zënë në grackë.

- Ja përgjigja e pyetjes tënde. Ti je mjaft i aftë për të bërë për vete një femër, këtë as që e vë në dyshim, por kur them qullac, dua të them që nuk je ende i zoti për t'i treguar vetes se e ke harruar të kaluarën.
- Aha, kjo qenka arsyeja, atëherë përse më shfaqesh përherë si pervers seksual, - ia ktheva unë i prekur në sedër.

Për çudinë time ai pohoi atë që thashë.

- Ndoshta. Ose ndoshta kjo është ajo që lejoj të shfaqet më shumë nga unë.

Fytyra e tij mori pamje serioze.

- Disa gjëra, edhe pse duken të paqëllimshme, vijnë si pasojë e një lufte të gjatë me demonët tanë, Jung. Duhet ta kesh kuptuar këtë gjë tashmë. Ti më shumë se askush. E di se nga e ka prejardhjen fjala “person”?
- Jo.
- Fjala person do të thotë maskë. Persona quhet maska e vënë nga aktorët e dramës greko-romake dhe ka gojë me tipare megafoni që shpërndan zërin me më fuqi. “Per-“ do të thotë “përmes”, ndërsa “sona” do të thotë “ajo përmes së cilës kalon tingulli”. Me kohën ky term është bërë njësh me figurën që ai përshkruan. Pra, fjala që dikur përdoret për një rol, për një aktrim, sot përdoret për të përcaktuar atë që ti je në të vërtetë. Ajo që ti u tregon njerëzve është maska jote publike. Ja përse ndoshta kjo figurë na shfaqet nëpër ëndrra si një dordolec. Por, gjithsesi, kaq është e gjithë filozofia. Prandaj, ki kujdes se çfarë i tregon botës! Mund të harrosh se kush je në të vërtetë.

Me të thënë ato fjalë, ai u ngrit dhe iu rikthye artit të të bërit kafe për klientin që sapo kishte hyrë brenda. Ishte një grua në të tridhjetat e saj. Baroni, duke

hedhur nga unë shikimin e tij tipik prej tinëzari, më shkeli syrin dhe u fut në një bisedë të thellë joshjeje me “viktimën” e radhës.

Në sfond filloi të luhej muzikë italiane. Në ajër sillej një zagushi ëndrrandjellës, që i jepte asaj melodie një shije gjarpëruese, e cila përdridhej në gjuhën tënde kur mundoheshe ta këndoje, duke lënë mbrapa pështymen e ëmbël dhe të athët të ndjenjave. Kishte qenë pikërisht ajo muzikë që më kishte prezantuar me diçka më tepër sesa përditshmërinë e ndjenjave kalimtare. Kishte qenë një sekondë në përfundim të notës së lartë, kur trupi i këngëtarit kishte pësuar një lëkundje të lehtë dhe shkëlqimi në sytë e tij ishte dridhur në sinkronizim me të vërtetën e tij dhe unë, ashtu me sytë e zgurdulluar, kisha kuptuar që e doja diçka të tillë. Që aty kishte filluar “lufta” ime kundër institucioneve që më diktonin kufij. Që aty kishte filluar rrugëtimi drejt të vërtetës sime, e me pakëz fat dhe harresa e asaj të vjetrës.

Kjo e fundit ishte finalizuar vetëm me një letër. Asgjë tjetër. Vetëm disa simbole mbi një fushë të bardhë. Dy vite kanë kaluar që atëherë dhe përsëri imazhi i asaj letre të sajuar në anën e saj të krevatit shfaqet krejtësisht i gjallë përpara meje.

“I dashur,

E mban mend kur thoshim se këngëtarët janë të vetmit që e përjetojnë lavdinë e tyre sapo këndojnë notën e parë? Që ata kanë në dorë mundësinë të shpërthejnë, të nxjerrin çdo emocion me anë të zërit dhe ta transmetojnë te çdokush që i dëgjon ato momente? Sa shumë që e donim atë ndjesi. Sa shumë e doja.

Është e papërcaktueshme kënaqësia që ato sekonda të japin. Të dy e dimë se gjithçka kemi është vetëm e tanishmja. Tani marrim frymë dhe ndërkohë që jemi duke bërë këtë gjë, ëndërrojmë për momentet që na e rrëmbejnë. Dhe

të tilla janë momentet që i kërkoj. Fjalët që shkruaj janë një monument i ndjesive të së shkuarës dhe ndoshta, nganjëherë, ato mund të jenë udhërrëfyese të ardhmes.

Por diçka mungon. Dhe të dy e dimë se çfarë. Të dy jemi ende në kërkim të saj, të së panjohurës që shpalos sekretet e saj më të thella, më të errëta, që na përqafton duke na marrë frymën. Vetëm këtë gjë dua. Të më merret fryma duke mos menduar që mund të vdes. Të humbas në emocionin e triumfeve. Të shpërthej si një poete që shfaqet për herë të parë përballë një salle të mbushur me njerëz e që pendohet në sekondën e fundit për poezinë që ka zgjedhur. Poemën më të errët të frikës së saj. Fjalën e parë që i është dashur një muaj ta gjejë. Fjalinë e fundit që duhet të përmbysë çdo gjë. Historinë e jetës në vetëm tri minuta. Vuajtjet, thyerjet e zemrës, talljet e shoqërisë ndaj pasioneve.

E kupton? Asnjëherë nuk e kam ditur si dreqin mundet një jetë të shpaloset në triumfin e një sekonde dhe përsëri, mes çdo kurioziteti dhe injorance, kjo është e vetmja gjë që dua të bëj.

Ti më kupton, apo jo? Kjo është arsyeja përse jemi bashkë. Të kuptojmë njëri-tjetrin. Harroje dashurinë. Të kuptohemi. Këtë kemi dashur gjithmonë. Dashuria është e pashmangshme kur dy vetë kuptohen.

Shpeshherë, kur dashuria më lodh dhe gjërat që ajo ofron ma frikësojnë shpirtin, arratisja ime nuk është humbja në turmën e njerëzve, me shpresën që dikush do të flasë dhe mendimet e mia negative do të zhduken pa lënë gjurmë. Mendimet nuk zhduken dhe të dy e dimë këtë gjë.

Ja përse dua ta gjej atë triumf. Të bëhem këngëtarja që rrëmben lavditë që pluskojnë në ajër. Të jem fryma që merret, poetja që përballlet me publikun që do ta ndjekë tërë jetën, pasi fjalët janë burgosja e saj e vetofruar. Dua të

jem revolucionit i të rinjve të një shoqërie që ka filluar të shembet, zanafilla e mendimit humanist që ndodhet brenda të gjithëve. Por që të mund të gjendem, në fillim më duhet të largohem.

Qoftë kjo një lamtumirë e shkurtër!

E jotja “Teori e Platonit”

E dëgjova këngën deri në fund, pastaj nxora nga çanta bllokun tim të shënimeve. Nuk isha tip që mbaja ditar, por qëkur kisha filluar të praktikoja ëndrrat lucide, një i tillë ishte i domosdoshëm.

Ëndrrat lucide janë një dimension hibrid i trurit, ku subjekti i ëndrrës është i vetëdijshëm për gjendjen e tij, pra që është duke ëndërruar, dhe si rrjedhojë mund të sillet njëloj si në jetën reale. Kjo praktikë ka tridhjetë vjet që është provuar shkencërisht, por të paktën një mijë vjet që praktikohet nga tradita budiste. Duke qenë një praktikë e mësueshme, ekzistojnë me qindra teknika për ta perfeksionuar, por të gjitha leksionet kanë të paktën disa baza të përbashkëta dhe njëra prej tyre është mbajtja e një ditari, shënimet e të cilit janë çdo ëndërr që ke përjetuar, në versionin më të freskët dhe të gjallë të kujtesës tënde.

Arsyeja përse po shfletoja ndër faqe ishte diçka që përmendi Baroni. E gjeta shënimin dhe duke lexuar u kujtova menjëherë për ëndrrën. Kishte qenë një ndër të parat. Kisha ëndërruar veten në një stacion të braktisur treni, ku përballë meje qëndronte një dordolec me kokën e mbështetur mbi gjunjë dhe duart e shtrira në drejtimin tim. Më ofronte një cigare të ndezur. Isha përpjekur të afrohesha, por një ndjesi më kishte kapluar çdo gjymtyrë; sikur në fakt po largohesha më shumë sesa po afrohesha; sikur ai përballë meje isha unë dhe thjesht duke u përpjekur për t’u afruar me të, po afrohesha drejt vetes. Sidoqoftë, kundër çdo force, isha gjendur pranë këmbëve të tij, e kur

ai kishte ngritur kokën e shikimet tona ishin takuar, një piskamë kishte shpuar ajrin ndërkohë që unë isha zgjuar duke kulluar qull në djersë.

Dola nga kafeneja dhe u takova përsëri me ajrin e ftohtë të dhjetorit. Nuk kisha ndonjë qëllim të caktuar në mendje, kështu që i lejoja këmbët të më udhëhiqnin nga të donin. Si përherë, rruga që ato morën ishte ajo drejt liqenit. Ndoshta për shkak të diçkaje që kisha lexuar diku se, nëse do të shihje me vëmendje për një kohë të gjatë lëvizjen e ujit, kuptimi i jetës do të shfaqej përpara teje me madhështi ose modesti.

Çdo pemë që shikoja, çdo gjethe që tashmë ishte tharë, më rikthente në kujtesë ëndrrat dhe vërtetësinë me të cilën ato shfaqeshin. Ishin kaq të vërteta, sikur e gjitha ishte thjesht një portë tjetër e jetës tënde, edhe pse gjatë ëndërrimit ti e dije se ishe në ëndërr, përsëri, mes gjithë atij ngazëllimi dhe frike, ti nuk mund të mos e mendoje si manifestim të një pjesë të vërtetë të trurit tënd.

Me aq pak herë sa e kisha praktikuar ëndrrën lucide, vërtetësia e saj ishte diçka që nganjëherë më krijonte probleme kur zgjohesha. Më duhej të ndiqja disa hapa që ta kuptoja se nuk isha më në atë gjendje kllapie, në atë botë tjetër të nënvetëdijes sime. Për shembull, dilja para pasqyrës sapo zgjohesha dhe shikoja nëse reflektimi im kishte ndonjë ndryshim prej të përhershmit, nëse afrimi i duarve apo largimi i tyre bëhej në madhësinë e zakonshme. Pastaj kërceja dhe e masja me mend se sa gjatë kisha qëndruar në ajër. Ose siç kisha mësuar kohët e fundit, mundesha thjesht të bëja një shenjë në dorë, t'ia hidhja sytë disa herë gjatë ditës dhe kur të isha në ëndërr, nëse shenja do të mungonte, atëherë do të shndërrohesha në lucid.

Nganjëherë trupi e di më mirë sesa mendja se për çfarë kemi nevojë më shumë dhe, në këtë rast, këmbët e dinin mjaft mirë nevojën e përhershme të inkubacionit të ëndrrës. “Inkubacioni i ëndrrës”, siç quhet në termin zyrtar,

ose thjesht “manifestimi i ëndrrës”, është një lloj terapie që të ndihmon të “përgatisësh ëndrrën”. Një e ecur e gjatë, pak minuta meditim në një vend të qetë, ku ti mund të vizualizosh atë që dëshiron të përjetosh.

Zakonisht nuk e bëja një gjë të tillë. Më pëlqente më shumë që ëndrra të më shfaqej pa ndonjë ndryshim nga ana ime. Nuk e di përse e kërkoja diçka të tillë, ndoshta sepse i kam me të vërtetë zët kufijtë që supozohet t’i vendosim vetes.

Liqeni ishte i pozicionuar në periferi të qytetit dhe ngaqë ishte ditë pune, të pakët ishin ata që uleshin për të qëndruar më shumë se pesë minuta. Pemët përreth ishin zhveshur të tëra dhe kjo bëri që një e dridhur të më përshkonte trupin, si të isha unë pema që ndiente të ftohtin. Është e çuditshme kjo ideja e të qenit një me gjithçka. Mëndjehapëse dhe e çuditshme.

U ula në stolin më të afërt. Anijet dhe skafet ishin të gjitha të ankoruara dhe ma bezdisnin keqazi pamjen kur era i lëkundte. Edhe pse, në fakt, kur përqendroja shikimin diku dhe humbisja në atë që isha duke menduar, pamja që kisha përpara nuk kishte dhe aq rëndësi. Ishte thjesht zhurmë në fushën e vetëdijes sime, një plan i dytë që nuk kishte rëndësi tjetër përveç të treguarit se realiteti nuk është ai që tregohet, por mënyra se si perceptohet.

M’u kujtua përsëri ideja e të vëzhguarit drejt, në lëvizjet e ujit. Kisha dështuar të gjitha herët; ndonjëherë gati për t’u hedhur në ujë si pasojë e hipnotizimit, por të kuptoja diçka ndryshe prej asaj që mendoja? Akoma jo.

Kështu, duke mos dashur të ndikoja ëndrrat e mia lucide, duke mos kërkuar me ngulm një ëndërr të caktuar ku unë të takohesha me demonët e mi, i përdora ato minuta për të reflektuar mbi të kaluarën dhe ashtu i humbur në fëmijërinë dhe adoleshencën e kaluar mijëra kilometra larg atij vendi, rrëshqita në mënyrë të pavetëdijshme në gjumë dhe nga gjumi në ëndërr.

KREU 3

Ajo m'u fanit e ulur afër dritares, duke menduar, përtej xhamit që i reflektonte shikimin. Nga asgjëja më pyeti:

- Çfarë është pafundësia?

Pyetja më zuri në befasi, por edhe nëse do të mund ta parashikoja, nuk kisha ndonjë përgjigje të denjë në mendje. Sigurisht që nuk ekziston një përgjigje e denjë për gjëra aq të komplikuara, por ajo priste më shumë nga unë.

- Është si eksperimenti i majmunit me makinën e shkrimit, - iu përgjigja unë pas disa minutash heshtjeje. - Që të kuptojmë pafundësinë, imagjino një majmun që shtyp butonat e makinës së shkrimit deri në pafundësi! Do vijë një moment kur krejtësisht nga rastësia, ai do të ketë shkruar të gjitha veprat e Asimovit.
- E pamundur! - tha ajo dhe ktheu vështrimin nga unë, duke kërkuar me sy një përgjigje më origjinale. E njihte këtë teori. Ajo nuk kënaqej asnjëherë nga gjërat e njëjta.
- E pabesueshme, e di. Por mos të harrojmë përjetësinë që ka në dispozicion. Për më tepër, ky është vetëm një eksperiment mendor.

Ajo që thashë sikur ia shtoi më shumë zhgënjimin dhe ktheu shikimin përsëri drejt dritares, duke gjetur horizontin e mëparshëm.

- Por unë jam i sigurt se mes atyre shkronjave, diku afër pafundësisë, do të jetë fshehur kombinimi i fjalëve që mund të përshkruajnë puthjen tënde.

Ngrita sytë që të takoja vështrimin e saj, por e vetmja gjë që mund të shihja ishte pasqyrimi në xham i buzëqeshjes tipike kur merrte atë që donte.

E pandreqshme, mendova me vete. Disa gjëra janë si pafundësia, nuk ndryshojnë kurrë.

Heshtja që pasoi ishte fare e shkurtër, por në mendje më peshonte sa një përjetësi e tërë.

- Ç'është jeta? - vazhdoi ajo.
- Oh, mjaft tani! - ia ktheva unë i irrituar. - Nga i gjen këto pyetje dhe ti!
- Ç'është jeta?! - Reflektimi mbi xham kishte marrë ngjyrën e vendosmërisë.
- Një teshtimë dinozauri më pak.
- Ë? Si the?
- Nuk të bënë veshët, jo.

Sytë e saj, vëmendja, reflektimi i shikimit të mbetur mbi xham, të gjitha të përqendruara mbi mua.

- Ç'do të thuash me “një teshtimë dinozauri më pak”?
- Është një mënyrë tjetër për të përshkruar rastësitë astronomike. Nëse një dinozaur i vogël, në një moment kur fshihej nga grabitqarët e mëdhenj, do të kishte teshtirë, ai do të ishte zbuluar e si pasojë do të shqyhej prej tyre. Kjo implikon një rrjedhë ndryshe të evolucionit, i cili me shumë mundësi do të kishte marrë një udhë tjetër. Probabiliteti tregon se ndoshta as do të ishim këtu për ta njohur atë mundësi.

Në sytë e saj lexoja epsh për të papërcaktuarën. Pyetjet për ta fikur atë zjarr vazhduan.

- Po vdekja?
- E vërteta absolute. Teshtima e dinozaurit tonë.
- Urrejtja?

- Mungesa e dijes.
- Spiritualiteti?
- Gjithçka jashtë fesë, brenda jetës dhe përtej.
- Ç'është ajo përtej?
- Nënvetëdija.
- Ç'është nënvetëdija?
- Ajo përtej.
- Ç'do të thotë “të pish”?
- Të mos mjaftohesh me shpirtin.
- Ç'është shpirti?
- Një krimb që shndërrohet në flutur. Buzëqeshja e një të panjohuri.
- Ç'është një i panjohur?
- Dy sekonda të së kaluarës.
- Ç'është e kaluara?
- Kuptimi i së tashmes.
- Ç'është e tashmja?
- E vetmja përjetësi.
- Ç'është përjetësia?
- Ta thashë njëherë: një majmun me makinë shkrimi.
- Ç'do të thotë të shkruash?
- Të luash shah me mendimet. Të njohësh përtej epokave mendime të njëjta me të tuat.
- Ç'do të thotë “e njëjtë” në këtë rast?
- Që të gjithë jemi një.
- Si mund të jenë dy veta një?
- Duke mbajtur teshtimën.

E ndali vrullin, mori frymë thellë dhe shfryu pyetjen e fundit.

- Ç'është dashuria?
- Mbajtja e teshtimës nga dinozauri ynë, që të mos zgjojë të vegjlit e vet.
- Hë, mos u tall!
- Ah, ajo dashuria?! Ajo është justifikimi i vetëm i teorisë tënde të Platonit dhe Mollës.

U bë të thoshte diçka, por fjalët iu ndalën në gojën e gjysmëhapur dhe me një shikim të zhgënjyer ktheu vëmendjen tutje, drejt një vendi dhe kohe të papërcaktuar.

E papërcaktuar ishte dhe mënyra se si ëndrra u mbështoll me vetveten dhe një tjetër pamje e njohur u shfaq në syrin e mendjes sime.

U shfaq në mesin e errësirës. Një zhurmë më kishte zgjuar nga gjumi. Ho-dha sytë drejt dritares dhe prita që sytë të mësoheshin me natën që ishte në prag të agut. Përballë meje u shfaqën ngadalë siluetat e objekteve që përditshmëria i kishte kthyer në diçka familjare. Nuk e di përse ajo zhurmë më shqetësoi më shumë se ç'duhej. Ato ishin të zakonshme për ne. Në fillim ajo i kishte urryer dhe net të tëra kishin kaluar nën shoqërinë e planifikimeve për të gjetur mjaftueshëm para për një banesë tjetër, por koha ka vetitë e saj misterioze dhe u deshën disa javë të mësohej e, për më tepër, të krijonte afeksion të veçantë me kaosin e atyre kërcitjeve shurdhuese. E kisha pyetur se çfarë e kishte bërë të ndryshonte mendje dhe ajo më ishte përgjigjur se ai kaos i kujtonte zhurmën brenda vetes. Në fillim e kishte trembur, sepse ishte një alarm i përditshëm i paqartësive që i lëngonin në zemër, por më vonë ato ishin kthyer në shoqëruesen e injorancës mbi veten.

Duheshin dhe disa minuta që të zgjohej nga gjumi. U shtriva duke peshuar mbi krahun e djathtë. Po e vështroja sikur të qe hera e parë. Përherë ishte

ashtu. Çdo mëngjes ishte një tjetër herë e parë që e shihja. Gjumi m'i rrëmbente të gjitha kujtimet me të dhe në mëngjes, e gjitha rifillonte nga e para.

Lëviza dorën mbi lëkurën e saj. Ishte po e njëjta lëkurë: e butë kur buzëqeshte, thumbuese kur inatosej, ndërsa në gjumë ngjyra e saj i përkiste diçkaje që qëndronte mes botës që është dhe asaj që duhet të jetë. Natën e kaluar kishte pirë shumë. Sa herë që dehej poshtë lëkurës së saj shfaqej një person tjetër: një femër që e di se çfarë do, por kokëfortësia e bën të presë që dëshirat t'i ulen vetë në prehër. Në momentin që dëshira do t'i plotësohej, ajo do ta kapte në duart e saj të vogla e do ta hidhte sa më larg të mundej, që ta shijonte veprimin nga e para, derisa t'i mbushej egoja, ose t'i dilte pija. Zakonisht ishte kjo e fundit.

Gjumi e zhvishte nga çdo dehje dhe kjo kuptohej nga mënyra se si çarçafi i prekte hiret. Ishte një përpjekje për ta mbrojtur nga të ftohtit dhe, në të njëjtën kohë, të mos e mbulonte më shumë se ç'duhej.

U shtriva me kujdes që të mos e zgjoja. Buzët i mbante përherë gjysmë të hapura. Një hapësirë i varej mbi gojë dhe unë digjesha nga dëshira për të ditur ç'mendime mbaheshin pa u thënë.

Ngjyra e lindjes së diellit, që përdridhej brenda në dhomë me përtaci, kishte një efekt të çuditshëm mbi trupin e saj. Më krijohej përshtypja sikur mbi të pluskonte një lloj aure transparente, një energji spirituale, e cila në vend të shëlbimit thithte jetën përjashta.

Budistët besojnë te ringjallja, por ndryshe nga ajo perëndimore, e cila si ide qendrore ka ruajtjen e kujtimeve dhe të mendimeve të jetëve të mëparshme, ringjallja budiste flet për pavdekshmërinë e energjisë së qenies, e cila shndërrohet në një formë tjetër jete, bazuar në mënyrën e jetës së kaluar. Kur e shikoja ashtu në gjumë, me energjinë transparente që i pluskonte mbi trup,

nuk mund të mos mendoja se, edhe nëse do të ishte ringjallur me mijëra herë, ajo e kishte gjetur një mënyrë për t'i mbajtur mend të gjitha dhe trupi i saj shtrihej mbi shenjat e jetëve që kishte jetuar. Duhej vetëm që zemra të mësonte t'u besonte shenjave.

Ende në ëndërr, por i vetëdijshëm për çdo veprim që do të pasonte, ula kokën mbi nënkresë dhe më kaploi një gjumë i thellë. Isha i pafuqishëm për të ndërruar qoftë dhe një veprim të asaj ëndrre-kujtim. Ideja të ngucja një moment të së kaluarës, qoftë dhe në një ëndërr të imponuar nga demonët e kujtimeve të mia, ishte sakrilegj. Atë mëngjes, disa momente pasi sytë e mi kishin humbur në pavetëdije, ajo kishte shkruar letrën dhe e kishte vendosur në anën e saj të krevatit.

Sapo më zuri gjumi në ëndërr, u zgjova në realitet.

KREU 4

Nxora ditarin instinktivisht nga çanta që të shënoja detajet e ëndrrës, por me t'u kujtuar se e dija përmendësh, e futa përsëri dhe vendosa të kthehesha mbrapsht.

Qielli kishte marrë ngjyrë të kuqërremtë dhe më dukej se kjo ndodhte jo nga fakti i thjeshtë se po perëndonte, por sepse ëndrra ishte subjekti i një realiteti më të madh sesa thjesht mendja ime; se qielli i mendjes ishte në fakt qielli i botës në të cilën jetoja dhe njerëzit, të cilët lëviznin me aq nxitim drejt jetëve të tyre, ishin frikat e mia më të thella që arratiseshin larg. Nëse i shihje me vëmendje, nëse e shquaje nën lëkure frikën që kishin, kuptoje sa e kotë ishte tentativa e tyre për t'u larguar, për ta fshehur veten ndaj vetes. Vraponin drejt marramendjeve, drejt alkoolit, drejt kinemave, drejt institucioneve që u tregonin çfarë të mendonin, vraponin drejt dashnoreve të reja, drejt drogave, drejt adaptimeve të keqimportuara të meditimeve orientale. Të gjithë vraponin drejt harresës. Vraponin larg vetes, larg asaj që mund të zbulonin, larg idesë se e gjithë jeta mund të kishte qenë iluzion, ëndërr ku kishin harxhuar kohën më kot, e prej të cilës nuk mund të zgjoheshin më.

Njerëzit nuk kishin frikë mos nuk u plotësoheshin ëndrrat. Njerëzit kishin frikë mos do t'u shkatërroheshin iluzionet. Dhe pastaj çdo vendim apo veprim që ata kishin bërë nën atë iluzion do të vishej me petkun e parëndësisë, me vellon e kotësisë. Por, nëse ti e kuptoje se gjatë kohës që ke besuar në një univers diktatorial dhe e vërteta mund të ketë qenë tjetër, atëherë vetëm ideja e të dhuruarit dashuri është ajo që ka kuptim në secilin rast. Vetëm dashuria qëndron përtej idesë se universi ka kufi. Nën putrat e saj të buta i gjithë universi ul kokën të ledhatohet.

Por ata njerëz nuk vraponin pas dashurisë. Për këtë isha i sigurt. E shikoja kudo. Te pastruesit e rrugëve. Te profesorët. Te kryeministri kur shfaqej në

televizor. Dukej sikur e tashmja ishte arratisur nga sytë dhe mendjet e tyre. Jetonin për të planifikuar të ardhmen dhe kujtuar të shkuarën. Planifikonin çdo detaj të pushimeve që vinin një herë në vit. Detajonin ditët dhe mbrëmjet. Fotografonin momentin, për t'u treguar të tjerëve se po jetonin momentin. Vraponin pas gjërave që ua mbushnin mendjen mjaftueshëm për të mos menduar. Punonin çdo ditë për të fituar mjaftueshëm para, për të blerë mjaftueshëm gjëra, që ta zinin mendjen se s'bën me diçka. Vetëm kështu mund ta justifikonin idenë e të bërit diçka që nuk iu pëlqente. Vetëm duke mos menduar.

Unë as që e kisha ndër mend të bëhesha pjesë e asaj turme, sepse e dija që egoja nuk mbushej ndonjëherë. Nëse kisha kuptuar ndonjëherë ndonjë gjë, kjo ishte. Në fëmijëri na frikësonin me figurat e përbindëshave, por sapo kalonim në adoleshencë, sikur harronin të na tregonin për shndërrimin e përbindëshit në diçka ndryshe, diçka që fshihet brenda nesh dhe jo poshtë krevateve. Diçka që nuk ngopet ndonjëherë. Pasqyra nuk mund t'i tregojë objektet që ia fshehim vetes. Dëshirat janë të fshehura në skutat tona më të thella. Si mund të fshehësh diçka, kur skutat janë të mbushura deng? Nuk mundesh. Ja përse duhet të krijosh një sistem fshirjeje, ku sapo një dëshirë e shkruar mbi sipërfaqe plotësohet, një fshesë e egos e pastron dhe një dëshirë e re zë vendin e saj. Kjo përsëritet çdo herë, çdo moment. Dhe kujtesa është bashkëpunëtore. Harron çdo gjë që implikon krimet e fshesës. Duket sikur i gjithë sistemi i dëshirave bazohet te paaftësia jonë për të kujtuar premtimet që i kemi bërë vetes. Sikur një alarm ndizet nëpër dhomëzat e kujtesës, sapo fillojmë të zëvendësojmë një dëshirë me një ëndërr, kur egoja krahason afatin kohor të përmbushjes së ëndrrës me atë të dëshirës. Është e papërballueshme për egon e njeriut, për mendimin e tij për veten dhe mjedisin në të cilin ai jeton, të zëvendësojë diçka afatshkurtër me diçka

afatgjatë; një iluzion që bën t'i sillet universi rreth vetes, me një të vërtetë që ia prish iluzionet.

Ndoshta kjo kishte qenë arsyeja pse kisha vendosur të provoja ëndrrat lucide atëherë kur një shok i universitetit ma kishte prezantuar këtë ide. Në fillim e kisha parë si lojë, si një aventurë që mund ta provoja në kohën e lirë, por tek e mendoj përsëri, arsyet e vërteta janë përherë të fshehura pas perdes së nënvetëdijes, brenda kujtimeve të së kaluarës, që duan të rikthehen edhe një herë, e pastaj të largohen drejt asgjësë, të qeta me misionin e tyre të përfunduar.

Nata e kishte lëshuar vellon e saj të zezë mbi tokë gjatë kohës që arrita tek apartamenti im dhe, me dorën e një piktori te dehur, e kishte pikëzuar me yje.

Përreth nuk kishte frymë njeriu. Ky mendim më jepte kënaqësi të veçantë. Ideja e të shijuarit të një darke nën shoqërinë e vetmisë nganjëherë ishte e parezistueshme. Kjo ndodhte më së shumti për arsyen se çdo njeri që takoja ishte kaq i dhënë pas bisedave të njëjta, pas muhabetëve të vogla që përsëriteshin e përsëriteshin, sa shpesh dyshoja në ekzistencë ndopak kreativitet në atë botë.

Përgatita diçka të shpejtë për të ngrënë, vendosa muzikë të lehtë instrumentale në sfond dhe u shtriva në krevatin e parregulluar që nga mëngjesi i asaj dite.

Kur trupi im prekte mëndafshin e lehtë të mbulesave të krevatit, gjendja e të reflektuarit vinte vetvetiu. Por eksperiencia më kishte treguar se mendimi i tepërt të krijonte një lloj përtacie, që justifikohet përherë me më shumë mendime. Dhe këto eksperiencia më së shumti lindnin nga mungesa e diçkaje, që të humbisja në të. Kaloja aq shumë kohë duke menduar për veten,

sa rrallëherë përpiqesha ta zbuloja. Përpiqesha ta përcaktoja, ta ndaja në pjesë e pastaj t'i ribashkoja në një rend të ri, në një figurë me më kuptim, por gjithë ç'merrja ishte një gjëegjëzë edhe më e ngatërruar se e para.

Ishte gati mesnatë. Dita kishte kaluar me përtacinë e një realiteti që pret ëndrrat të përmbushen vetvetiu. Ëndrra erdhi lehtë, ashtu siç vetëm dashuritë e pamundura dinë të afrohen.

Ndodhesha në një pyll. Pemët ishin të larta, të dendura dhe drita e diellit ia dilte me zor të hynte nga ndonjë shteg. Ajri ishte i ngjyrosur me errësirë. Përreth, disa sy filluan të shfaqeshin nga asgjëja dhe frika filloi të nxirrte efektet mbi prenë e vet. Intensiteti i hamendësimeve të mia e tregonte shkoqur tmerrin që më kishte pushtuar. Sytë u zhdukën përsëri në errësirë, por frika qëndroi me mua. Ishte e çuditshme mënyra si ndihesha. Isha i tmerruar, por një pjesë brenda meje e pëlqente. Dukej sikur e shijonte ndjenjën e të panjohurës, sidomos atë që tregonte rrezik, sepse e lejonte të ishte gjallë, të ndihej plot jetë.

Hodha një hap drejt errësirës. Pak nga pak sytë u mësuan dhe fillova të orientoheja larg pengesave, kryesisht pemëve ose shkurreve. Ndjesia e frikës ishte zbutur, por sapo ndihesha pak rehat, diçka ndodhte - një lëvizje në errësirë, zhurmë e një insekti - dhe frika kthehej me turr drejt meje, ashtu si kthehen të dashuruarit në krahët e njëri-tjetrit pas një minute mungesë.

Errësira po bëhej gri. Aty nga mesi i rrugës u detyrova të ndalem. Udhëndahej në mes nga një rrjedhë. Ula sytë për të matur gjerësinë e rrjedhës dhe, kur i ngrita përsëri, një siluetë u shfaq ulur në një stol, po ashtu si të ishte shfaqur nga hiçi. Grimca të ftohta akulli më kaluan mbi lëkurë. Shikimi i të panjohurit ndodhej diku përtej pemëve. Mendova të kthehesha mbrapa, por një e menduar e dytë më bindi se kjo ishte marrëzi. Nëse diçka e keqe do të ndodhte, atëherë do të shfaqesha si çdo natë në krevatin tim. Hodha sytë te

parakrahu i djathtë. Po kërkoja shenjën e realitetit. Mungesa e saj më qetësoi dhe, gjithashtu, intensifikoi vetëdijen se po ëndërroja.

Në lëkurë kaloi ndjesia e vjetër e ankthit të realitetit. U tërhoqa disa hapa mbrapsht dhe mora turr. Me pak sforco arrita të kaloj në anën tjetër. Prita disa sekonda sa të më kthehej fryma dhe u ula në stol, përbri të panjohurit.

- Më falni, - e pyeta. - Dini gjë ku ndodhemi?

Fytyra e tij, e cila nuk shfaqte shenja jete, nën atë dritë të zbehtë qiellore, m'u duk e njohur.

- Ke humbur? - ma ktheu ai.
- Më duket se po.
- Për ku je nisur?
- Se di. Diku larg frikës. Ky vend më fut të dridhurat.
- Nëse ky vend të frikëson, përse ke ardhur këtu?
- Ndoshta pikërisht për këtë arsye. Gjithsesi, nuk ishte në dorën time.
- Por është tani, apo jo?
- Po.
- Atëherë, ku është problemi?
- Problemi është se nuk e di ku jam. Si ta di ku të shkoj, nëse nuk e di ku jam?
- Nëse unë do të ta thosha emrin e vendit, do të ndihmonte ky fakt ndopak?
- Ndoshta. Nuk e di.
- Ke frikë nga e panjohura, djalosh?

Fytyra e tij po bëhej përherë më e njohur.

- Kam. Dhe s'kam. Nuk e di. Është ndjesi e përzier. Njëra gjysmë më thotë të ndalem, tjetra thotë të kundërtën.
- Atëherë, nuk ka rëndësi të dish ku je. Je në vendin e duhur. Thjesht, vazhdo përpara!
- Por nuk e di ku? Përse? Çfarë arrij nëse shkoj përpara? Më duket e pakuptimtë.
- Nëse qëndron në vend, çfarë do të mësoje?
- Asgjë. Thjesht do të qetësohesha. Kjo do të ishte ndjesi e rehatshme, besoj.
- Por s'do të mësoje gjë tjetër?
- Jo.
- Po nëse do të ecje përpara?
- Të thashë që nuk e di.
- Pra, ti mendon se po të ecje përpara nuk do të arrijë gjë tjetër, përveçse më shumë frikë.
- Po... Jo. Ndoshta do të arrija më shumë. Do të shuaja kuriozitetin. Ndoshta dhe do të zbuloja diçka. Nuk e di.
- Por ekziston mundësia që të zbulosh diçka tjetër, apo jo?
- Po, sigurisht. Mundësia ekziston përherë.
- Atëherë, ç'pret?

Gjatë kohës që ecja përmes errësirës, duke goditur përpara me grushte drite, hasa një mur barishtesh dhe duke luftuar me duar t'i largoja nga rruga u shfaq përpara një dritë e fuqishme dhe pas një sekonde e gjeta veten me sytë hapur, të shtrirë në krevat, duke kujtuar vagëllimthi fytyrën e të panjohurit, të veshur me një qeshje të rëndë tinëzare, që lëvizte gishtin tregues lart e poshtë.

KREU 5

Qëndrova për disa minuta të mira i shtrirë në krevat, me mendjen e përqendruar në asnjë mendim të veçantë dhe me sytë e humbur në bardhësinë e mureve. Pastaj, ashtu i humbur si në një zhgjendërr, hodha shikimin te parakrahu i djathtë, për të shquar shenjën që më ndihmonte të kujtoja realitetin. Dhe ja ku ishte, e ndriçuar nga ca fije hëne që hynin vjedhurazi nga grilat e kthyera, një simbol i vogël shigjete përçonte në mendjen time qetësinë e përfundimit të maktheve.

Hodha sytë drejt orës së varur në mur. Ishte anuar përsëri. Çdo herë mëjanohej nga njëra anë dhe asnjëherë nuk e kisha kuptuar përse. Mos ndonjë fantazmë kishte qejf të luante me mendjen time, a çifti në dhomën ngjitur vazhdonte avazin e zakonshëm të seksit të dhunshëm, pa dashur t'ia dinin se jetonin në një kompleks të ndërtuar me mure letre; kjo pyetje më trazonte përherë. Duke mos besuar në fantazma dhe duke u ribindur që dhuna në seks ishte e dëmshme për gjumin dhe se ora mund të anohej sa të donte, por koha as që do të tundej nga kokëfortësia e saj për të mos u ndalur ndonjëherë, ashtu, gjysmë i marrakotur e gjysmë i vetëdijshëm, u ngrita nga krevati me hapa të lehtë dhe përfundova në ballkonin e vetëm të godinës.

Kisha mundur disi të gjeja një cigare në xhepin e brendshëm të xhaketës dhe po tymosja në qetësi. Përreth nuk dëgjohej gjë. Qe shkreti zhurmash dhe qielli dukej lart, përmes tymit të duhanit, si një copëz pëlhure gjigante e shpuar me gjilpërën e zotave. Nga asgjëja më erdhën në mendje fjalët e Baibës se sa i pafund ishte universi dhe se sa e paperceptueshme ishte ajo ide për mendjet tona. Sado që përpiquesha ta rrokullisja atë mendim drejt kuptueshmërisë, aq më shumë arratisesh drejt pakuptueshmërisë. Ishte me të vërtetë e pamundur të imagjinoje madhësi të tilla.

Dhe ashtu, duke kundruar yjet lart në qiell, m'u kujtua si në tym një teori e universit kuantik që kisha lexuar në një libër fantashkence. Sipas kësaj teorie të quajtur “Ngatërresa kuantike”, atëherë kur i gjithë universi kishte qenë sa një pikël drite, në të, të gjitha atomet kishin lëvizur në unitet dhe në njëtrajtshmëri. Pastaj kishte ndodhur diçka dhe i gjithë universi kishte shpërthyer duke përshpejtuar përgjatë miliarda viteve drejt kësaj që ekziston sot: unë, ti, pemë, kafshë, galaktika, “Vrima të Zeza”. Por edhe pse atomet e asaj pikle janë shpërndarë larg njëri-tjetrit, nuk ka ndonjë arsye përse të mendohet se lidhja e tyre ka humbur dhe, në fakt, eksperimentet tregojnë që edhe nëse atomet janë larg njëri-tjetrit, edhe nëse mes tyre qëndron një kontinent apo një galaktikë, kur njëri atom lëviz, tjetri lëviz në unitet me të.

Në fillim më ishte dukur se kjo ishte pjesa fantastike e fantashkencës, por nga kërkimet që bëra më pas zbulova se në fakt ekzistonin prova të bindshme që e verifikonin vërtetësinë e saj.

Ky mendim, ashtu i ardhur nga largësia e pamatë e yjeve, tejshpoi tymin e duhanit dhe u ngul në mendjen time, duke më thelluar bindjen se, edhe nëse fati mund të mos ekzistonte, një forcë tjetër luante rol në univers, forcë që luante me veten një lojë më pak kaotike, më tërheqëse ndaj elegancës së rregullsisë. U përpoqa për një moment ta lidhja me ndjesinë që kisha përjetuar në shoqërinë e Baibës, por sapo e provoja, ajo sikur e humbiste vërtetësinë dhe pjesa fantastike merrte rolin kryesor mes meje dhe saj.

Koha kishte kaluar pa u ndjerë. Në gojë më kishte mbetur veç bishti i cigares, të cilin e pështyva bashkë me ndjesinë e thartë që më kishte lënë në gjuhë. Siç kisha ardhur, gjysmë në gjumë, gjysmë në ëndërr, u ktheva në dhomë dhe u hodha mbi krevat me shpresën se gjumi do të vinte vetëm, këtë herë i pashoqëruar nga pesha e ëndrrave.

Gjumi më doli pa gdhirë. Rrallë zgjohesha vonë, sepse gjithmonë, kur dielli kalonte qiellin e lindjes më shumë se njëzet gradë, në mendjen time dita quhej e humbur dhe më duhej të vrapoja të kapja minutat e ikura. Paradoksalisht, e gjithë kjo binte në kundërshtim me mënyrën si i kaloja ditët (ose, të paktën, me mënyrën si të tjerët i kalonin ditët).

E gjeta veten përsëri në ballkon dhe këtë herë sipër meje shtrihej një qiell pa re. Në mendje m'u kthyen përsëri fjalët e Baibës, por, me yjet e fshehur pas pëllhurës shndritëse së diellit, ajo pafundësi ishte më pak e frikshme. Cepat e saj dukeshin më të afërt dhe, si rrjedhojë, rëndësia ime më e prekshme.

Poshtë njerëzia kishte filluar avazin e përditshëm. I shikoja me vëmendjen që tenton të depërtojë mendimet e tyre, jo për të gjetur se çfarë mendojnë, por për të kërkuar mekanizmin e rehatisë, atë burimin e durimit të tejskajshëm që shfaqnin. Si dreqin ia dilnin? Të zgjoheshin dhe të rifillonin çdo gjë nga e para, sikur asgjë të mos kishte ndodhur, thellë-thellë duke e ditur se do të bënë të njëjtat gjëra, të njëjtat biseda, të njëjtat takime? Mjaftonin disa ditë ndryshe të justifikonin një vit të njëjtë? Njerëzit që shikoja më demontronin se po, mjaftonin, por diçka brenda meje nuk mund ta pranonte një gjë të tillë. Diçka brenda meje, e cila adhuronte idenë e përjetësisë së një momenti, në të njëjtën kohë urrente idenë që ai moment mund të ishte i njëjtë për tërë përjetësinë.

Ishte gjithçka kaq e planifikuar. Në këmbim të sigurisë kishim tradhtuar instinktin më të fortë të qenies sonë, atë që e krijon jetën e njeriut brenda sekondës, që i jep arsye të zgjohet në mëngjes, të dalë në ballkon e të mos mendojë për gjë tjetër, veçse sa i pafund është qielli dhe sa i pamjaftueshëm është ai për shikimin e tij. Kishim braktisur frikën dhe si pasojë kishim rrënuar shpresën për të gjetur një kurë për atë monstrën e vogël brenda nesh, e cila edhe pse ushqehet me frikën tonë, në mungesë të saj, ajo do të qëndrojë

përherë aty, duke fjetur, për të mos na braktisur asnjëherë. Sepse, nëse do të kishim frikë, atëherë ajo do të zgjohej dhe ne do të vepronin kundër saj, ta vrisnim, sepse vetëm ashtu do ta zbulonim se ku dreqin flinte - në zemër, në mendime, në dritaren më të lartë të shpirtit apo në derën më të ulët të stomakut. Por në gjumë gjithçka ishte errësirë dhe që monstra të mundej, nevojitej dritë. Dhe atë mëngjes të freskët dhjetori, aty në ballkonin e atij qielli të pa-fund, frika ime kërkonte me ngulm që ta zgjoja.

Dola nga apartamenti pa futur gjë në gojë. E filloja ditën përherë me kafe shqeto. Sapo hyra në kafene, Baroni, i cili më priti me buzëqeshjen e tij tipike, filloi ta përgatiste një kafe të tillë.

- Asnjëherë s'kam për ta kuptuar se ç'dreqin do që zgjohesh kaq herët, - tha ai.

M'i thoshte përherë këto fjalë, a thua se do të vinte një ditë kur tingulli i tyre do të ishte i atillë sa të ma ndryshonte mendjen. Dhe unë, si gjithmonë, i ktheja të njëjtën përgjigje - një heshtje të gjatë, që pasohej me një rikujtim të mëngjeseve kur zgjohesha për të kundruar atë tek flinte ngjitur meje.

E largova filxhanin tutje, më shumë për të larguar athtësinë e kujtimeve sesa të kafesë, dhe ndeza një cigare, me mendjen duke rrëshqitur drejt idesë se veset e së kaluarës qëndronin me ne deri në momentin që i kujtonim.

Kafeneja ishte bosh shumicën e kohës. Klientelë kishte shumë, gjithsesi, por ata hynin dhe dilnin nga dera çdo moment. Me hapa të shpejtë mbërrinin banakun, porositnin një nga ato kafetë-për-të-ikur dhe, pasi kthenin majat nga thembrat, ia fusnin një vrap i mund ta bënin vetëm njerëzit në dijeni të një sëmundjeje të rëndë. Dhe përsëri, ne të gjithë do të vdisnim. Nëse e shikoje nga këndvështrimi i duhur, ky duke qenë një këndvështrim realist,

në fund të gjithë do të vdisnim. Por seç kishim një fiksim për ta bërë të padukshëm këtë fakt. A thua se, nëse ti do të ndaloje së menduari për një gjë, ajo do të zhdukej. Kështu silleshim me vdekjen. E largonim tutje me idenë që ta jetonim jetën në qetësi, të sigurt nga kthetrat e të vetmes gjë që do na e vidhte. Por nëse e shikoje nga një këndvështrim tjetër, këtë herë për të qenë brenda kufijve, ky duke qenë këndvështrimi im, e vetmja gjë që e bënte jetën të furishme ishte ideja që vdekja fshihej në kthesën tjetër. Dhe ai vrapim, ajo ecje e shpejtë nga banaku drejt derës ishte gjithçka përveç një vrapimi që e dinte se vdekja po e priste pas disa hapash. Ai vrapim ishte babëzia e tmerrshme për diçka më shumë se jeta. Por çfarë dreqin kishte atje jashtë më të madhe se jeta? Zyrat? Kontratat? Ngritjet e rrogave? Qendrat tregtare? Televizori? Të gjitha këto ishin brenda jetës dhe në njëfarë mënyre ato ishin bërë më të rëndësishme se ajo. Ato ishin kthyer në zhurmuesin që kishim frikë ta fiknim, sepse në mungesë të tij ne mund të ndiheshim vetëm, të padobishëm, se mund të kujtoheshim që të jemi vërtet të lumtur, duhet të fillojmë të punojmë me veten dhe që të punojmë me veten, do të thotë të ndezësh dritën për të gjetur monstrën përbrenda dhe që të gesh monstrën, do të thotë të përballesh me frikën dhe që të përballesh me frikën, do të thotë ta shikosh veten drejtpërsëdrejti në pasqyrë e jo thjesht të kalosh shkarazi saj.

Të ndalesh! Ja, kjo është. Jo të vraposh sa andej-këtej, a thua se diçka të pret atje në horizont që do të justifikojë çdo lloj vuajtjeje. Sepse nëse kisha kup-tuar ndonjë gjë nga vitet e mia nëpër institucione, ishte që ne e manifestojmë suksesin nëpërmjet vuajtjes. Sa më shumë të vuash, aq më i madh sukcesi dhe merita që ke ndaj suksesit. Sa më shumë djersë të derdhësh, aq më shumë do të ndihesh krenar për veten. Tani, le të mos keqkuptohemi, sepse nëse dikush do që të arrijë diçka, atëherë ai, ose ajo, sigurisht që duhet të punojë shumë për ta arritur atë qëllim. Por kjo më duket sikur është keqkuptuar e gjitha, sepse tani fëmijëve u ushqehet ideja që ata mund të bëjnë çfarë

të dëshirojnë nëse punojnë si të çmendur. Po, ata kanë të drejtë, por kjo është kaq e padrejtë. E padrejtë, sepse një i ri ndoshta nuk e di se çfarë do në të vërtetë dhe, si pasojë e një fryme ndikuese nga një i rritur, futet në një udhë të jetës që nuk e shijon. Dhe është kjo ide, ideja se ai mund t'ia dalë asaj rruge, që bën të mundur rritjen e indiferencës së tij ndaj rrugëve të tjera. Kjo eliminon në mënyrë automatike mekanizmin më të efektshëm për gjetjen e asaj që do zemra - mekanizmin e gabimeve. Sepse vetëm nëse ke provuar artin, mund të kuptosh që shkenca është ajo që ti do. Sepse vetëm nëse ke provuar sportin, mund të kuptosh që historia është ajo që ti do. Por kur ti futesh në udhën e historisë, kur ti futesh në maratonën e sportit, kur ti futesh në udhëkryqet e artit, kur ti futesh në komplikimet e shkencës dhe mendimet e tua i mjegullon ideja se mund t'ia dalësh secilës udhë, atëherë mundësia që ta gjesh dëshirën e vërtetë të zemrës tënde bëhet po aq e largët sa edhe njohuria për veten tënde.

Nga larg Baroni më shikonte ngultazi. Persona, më dukej se më thoshte. Njeriu që i tregojmë botës s'është askush tjetër veçse imazhi i pasqyrës që kalojmë shkarazi. Por, në fakt, sytë e tij po shikonin diku sipër meje, përtej dritares rrëzë së cilës isha ulur.

Ktheva kokën instinktivisht dhe horizonti i shikimit tim u mbulua nga dy sy të ngjeshur pas xhamit, që dukej sikur kishte vite pa u pastruar.

Ishte Magda, e para femër me të cilën kisha pasur lidhje pasi isha larguar nga Shqipëria. E ftova të ulej me mua dhe pa kursyer kohë, iu futëm një bisede të zellshme, e mbizotëruar nga grimca të asaj aventure të shkurtër që kishim kaluar.

Duke qenë se largimi im nga Shqipëria kishte përkuar me largimin e saj, i kisha menduar krahët e një femre tjetër si rruga e vetme për të harruar dhe, në njëfarë mënyre, për t'u hakmarrë.

Arsyeja e kohëzgjatjes së shkurtër të asaj lidhjeje nuk kishte qenë më shumë paaftësia ime për të harruar, sesa paaftësia e Magdës për t'u shfaqur e kënaqshme. Ishte tepër e ngutshme dhe sillej sikur lexonte këshilla nga ato gazetaret, që mendonin se dinin si t'u bënëin magji meshkujve, për t'i pasur përherë në kthetrat e tyre. Nuk u desh shumë që bindja të më faktohej, kur gjeta një revistë të tillë në dhomën e saj.

Magda ishte tipike ballkanase, e gjatë, me trupin e rregullt, me fytyrë që të dhuronte epsh, por që, për disa arsye të panjohura, sapo hapte gojën, ma shuante dëshirën aty për aty. Ja përse nuk e arritëm asnjëherë maksimumin e marrëdhënieve tona seksuale. Sa herë që arrinim kulmin e lojërave me trupat tanë, sapo shikoja rrëzë krevatit foton e të dashurit të saj, dëshira fikej dalëngadalë dhe më pas, kur ajo tentonte të përlligjte veprimet, si për t'i vënë kapakun, një si lloj përbuzjeje më kaplonte çdo dëshirë. Ishte Magda ajo që më bëri të dëshmoj në mënyrë të pastër atë që deri atëherë veçse kisha hamendësuar: tentativat e dëshpëruara të disa femrave për t'i kthyer qëllimet e tyre në diçka që vjen rastësisht, diçka që e tejkalon ndikimin e tyre mbi realitetin e ngjarjeve. Dëshira u lexohet kaq lehtë në sy, por ato janë aq të sigurt në pastërtinë e dëshirës së tyre, saqë zgjidhja e vetme që u mbetet është të hedhin gurin, por të fshehin dorën. Por, pavarësisht se ky është një veprim që nuk e pëlqej dhe aq, ideja e një guri të hedhur është më e kënaqshme sesa e asnjë guri.

Guri i dytë i hedhur drejt meje vinte nga Europa Lindore. Ishte i rëndë, që peshonte në vendin e vet dhe, nëse Magda e fshihte dorën, Anzela e tregonte me krenari drejt meje. E takova Anzelën fare rastësisht, një natë kur po kthehesha me Magdën nga një festë e vogël në qendër të qytetit. Ato njiheshin me njëra-tjetrën, i kishin dhomat ngjitur, por, çuditërisht, nuk e kisha vënë re më parë fytyrën e saj të ëmbël. Gjatë gjithë rrugës, Anzela, e

shoqëruar nga një shoqe, hidhte shikime të drejtpërdrejta, të cilat sapo i vura re krijuan brenda meje një kuriozitet të paeksploruar më parë. Lidhja me Magdën kishte arritur në fazë ngrirjeje dhe mjaftonte vetëm pak gërricje që akulli të thyhej krejtësisht. Ajo gërricje që Anzela.

Ndryshe Magdës, ajo që më tërhiqte drejt Anzelës ishte vërtetësia me të cilën shpalosej para meje. Gjithçka ishte e vërtetë në qenien e saj. E folura e saj ishte e vërtetë. Shijet muzikore. Opinione kryeneçe. Mënyra se si flinte ishte e vërtetë. Por, mbi të gjitha, shpalosja e pafrikë e seksualitetit të saj ishte kyçi i gjithë asaj vërtetësie. Eksitohej disa herë në ditë dhe i duhej vullnet i hekurt për ta frenuar veten ndaj rrugës aq të ftueshme të “mëkatit”. Me mua ajo mëkatoi vetëm tri herë. Herën e parë ndodhi në dhomën time, kur pasi kisha dështuar dy herët e para për ta shtënë në dorë, herën e tretë ajo u vetofrua, duke zhveshur para meje trupin e saj jo fort të gjatë, por të lidhur, me lëkurën e butë që i shndriste në gjysmerrësirë. Lidhja jonë ishte e lirë, që ndalej te kufijtë e një miqësie vetëm për shfryrje seksuale, gjatë të cilave përherë do të ndodhte diçka që ta frenonte shfryrjen e plotë të orgazmave.

Herën e dytë, pasi kishim pirë verë në dhomën e saj dhe sa po fillonim lojërat e nxehtë, papritur ra telefoni. Pavarësisht përpjekjeve për ta injoruar atë telefonatë, ajo u shkëput nga trupi im dhe u lëshua drejt celularit. Një shoqja e saj, e ardhur nga larg për t'i bërë surprizë, nuk donte dhe shumë minuta të shfaqej në derë. Me ngut mbaruam diçka që supozohej të vazhdonte gjithë natën dhe me lëngjet e mia të shfryra para kohe nëpër këmbët e saj, iu drejtua banjës, ku u pastrua dhe u vesh, ndërsa unë dola nga dhoma i zhgënjyer, por gjithashtu i ngadhënjyer nga mënyra se si rastësitë përkonin gjithmonë në momentet më të papërshtatshme.

Herën e tretë, më shumë nga një pezmatim i brendshëm sesa ngërç trupor, aty në mes të aktit, i humbur në kënaqësitë e orgazmave të vogla, fytyra e saj

m'u shfaq si vegim dhe u sul drejt meje me vrull të lehtë e të ftueshëm, aq sa të më trulloste drejt pëshpëritjes së emrit të saj.

Që atë natë marrëdhëniet e mia me Anzelën u ftohën dhe kur u takuam përsëri, pas disa muajsh, ajo më tha se kishte rënë në dashuri me dikë tjetër. Pavarësisht kësaj tronditjeje të lehtë, vera bëri të veten dhe unë e ftova për një rikujtim të kohërave të vjetra. Nuk pranoi.

Është interesante filozofia e disa femrave. Kur janë të lira përjetojnë eksperiencë seksuale nga më të çmendurat, por, kur angazhohen në lidhje përtej atyre seksuale, vështirë se mund të tundohen drejt tradhtisë. Ja përse shoqëria që respekton seksualitetin e njerëzve lind shkencëtarë, filozofë dhe artistë që revolucionizojnë fatin e vetë asaj shoqërie, ndërsa ato që ndrydhn seksualitetin e tyre lëngojnë akoma në dilema mesjetare.

Ndoshta ja përse e kisha harruar Magdën aq shpejt. Ndoshta ato femra që kërkojnë të të ngjiten me çdo kusht, janë ato që të shqiten nga mendja më shpejt. Ndërsa Anzela, pavarësisht se pak ndjenja ishin përfshirë në marrëdhënien tonë, liria me të cilën kishim përjetuar njëri-tjetrin, tejshponte dhe gjykimet më të egra të shoqërisë.

Por femrat që guxojnë të evokojnë të tilla efekte janë të rralla dhe ajo që kisha përballë e ridëshmonte atë fakt. Përsëri duke folur ngutshëm, përsëri, siç dukej shkoqurazi, duke marrë këshilla nga revistat. Tek fliste, Magda ishte sa e afërt, aq dhe e largët. Mbaja mend çdo gjë që kisha përjetuar me të, por si pasojë e disa arsyeve të pakuptimta nuk ia pranoja vetes. Doja ta fshija nga kujtesa, doja ta përlligjja me idenë e hakmarrjes ndaj ndjenjave të mia për dikë tjetër, por diçka më ndalonte. Ndoshta ishin iluzionet që i diktoja vetes. Ndoshta ato janë pengesat kryesore në rrugën drejt vetvetes.

Por përsëri, si mund të përlligjet diçka që e bën me vetëdije?

Ndoshta vullneti i lirë është vetëm një iluzion. Përndryshe, si e vendos çfarë mendimi të mendoj? Si e vendos çfarë fjalie të shkruaj? Në momentin që vijnë mendimet unë di se çfarë duhet të bëj, por si drejtin vijnë mendimet?

Shopenhauri kishte të drejtë. Njeriu mund të bëjë çfarë të dojë, por jo të dojë çfarë të dojë.

KREU 6

Magda iku, ndërsa Baroni po bisedonte me një të moshuar për të mirat dhe të këqijat e kafesë. Po luaja në heshtje me lugën brenda filxhanit, duke mos menduar asgjë në veçanti. Pastaj papritur brenda meje lindi një ndjesi. Ishte e njohur, por e largët, si një nga ato ndjesitë me të cilat je rritur, por si pasojë e rrënjëve që kanë lëshuar brenda teje, të lind dëshira për liri, për t'u shkëputur nga vendi që e ndjell burgosjen. Ishte një lloj monotonie, por jo krejtësisht ashtu. Më shume afrohej drejt urisë së ngopur me vetëm një vend, një shtëpi, një kafene, një ndjesi.

Më kishte ndodhur dhe më parë, disa javë pasi ajo kishte ikur. Ndoshta kjo kishte qenë arsyeja përse isha larguar nga Shqipëria. Dhe kishte funksionuar. Menjëherë, sapo territore të reja ishin shfaqur në horizont, ajo ndjesi ishte larguar, duke lënë mbrapa vetëm gjurmë të zbehta malli.

Tek po mendoja si ta largoja, kuptova që mundësitë e mia këtë radhë ishin më të limituara. Para kisha aq sa për të paguar shkollën dhe nevojat bazë të përditshmërisë. Aty-këtu kisha ndonjë kursim, por ishte i pamjaftueshëm për të ndërmarre udhëtime të gjata, jo më të shpërngulesha në ndonjë qytet tjetër. Luajta për disa minuta me ide të ndryshme. Ato varionin që nga gjetja e një pune të dytë, deri te përdorimi i parave të shkollës për një udhëtim të gjatë, ndoshta në Spanjë, pasi kisha dëgjuar për “Rrugën e Santiagos”, një rrugë pelegrinazhi që bëhej nga ata që kërkonin diçka të humbur brenda vetes. Mendimi që të kthehesha në Shqipëri nuk e goditi për asnjë moment cipën e hollë të reflektimeve të mia. Mall kisha, shumë madje, por kthimi në vendin e zanafillës së asaj ndjesie ishte si të blije një çadër në shkretëtirë, me mendimin se dikur do të binte shi.

Duke rrëmuar në veprimtaritë e ditëve të fundit, papritur u kujtova për shokun tim, i cili kishte organizuar një kamping në malet aty afër dhe fytyra ime

shndriti nga ekzaltimi. Nuk u desh shumë që ai mendim të shpërndahej kudo dhe ndjesia e zyrtë u largua pak më tutje kraharorit tim. Hodha shikimin majtas dhe përmes xhamit të ndotur mund të shihja zbehtazi majat e vargmaleve, që ushtonin madhështinë e tyre me valë të lehta mjegullnajash. Kontaktova menjëherë shokun që kishte organizuar ekskursionin dhe me buzën në gaz shënova në mendje orën e nisjes. Ktheva kokën nga Baroni dhe, pavarësisht se nuk e kishte mendjen, me vete i thashë se Persona e shikonte nganjëherë pasqyrën me bisht të syrit dhe pak nga pak do të vinte koha kur do të gjendej krejtësisht përpara saj.

Që të mbërrinim destinacionin na u desh të ngjisnim disa qindra metra të mira mal. Shkëmbinjtë nuk ishin shumë të thepisur, gjë që na e lehtësoi ngjitjen e, për më tepër, një shteg shtrihej përpara nesh, i cili krijonte goxha kontrast mes rrugëve të hapura nga njeriu dhe virgjërisë së natyrës.

Gjatë udhëtimit zakonisht i mbaja sytë poshtë, duke pasur kujdes ku i vija këmbët, por kishte momente kur një shtytje e ardhur nga mjegullnaja që kishim lënë poshtë në fushë më detyronte të shikoja sipër dhe menjëherë më kaplonte marramendja. Më pas, kur sytë e mi pikasnin majën e malit, një lloj njëtrajtshmërie pushtonte shtyllën time kurrizore, sikur palca e malit ishte palca ime dhe unë po ecja mbi shpinën time.

Në fund arritëm në një fushë të vogël dhe njerëzia e ndaloj marshimin, duke sinjalizuar ngritjen e çadrave të kampingut. Pasi mbarova së rregulluari çadrën, gjë që më mori goxha kohë, u krodha në një zbulim të tërthortë të malit.

Muzgu donte fare pak të arrinte. Sipër meje avionët gumëzhnin zhurmshëm, ose isha unë ai që imagjinoja zhurmën e motorëve të tyre, pasi shikimi gënjehej lehtë nga iluzioni i lartësisë. E mahnitshme, mendova me vete. Ajo psherëtimë mendimi u kap diku pas bishtit të avionit dhe e harroi fare

madhështinë e maleve përreth. E harroi, sepse, pavarësisht se unë isha një milingonë në krahasim me malin, atje lart dikush po më shikonte nga dritarja e avionit dhe ne, mali dhe unë, do t'i shfaqeshim përnjëherësh të vegjël, njëkohësisht të parëndësishëm. Egoja e atij njeriu do të përdhunohej nga vogëlsia e objekteve, që në jetën e përditshme ia vidhnin frymën nga madhështia.

Njeriu kishte arritur më në fund të fluturonte, por përveç krijimit të krahëve, ai kishte zbuluar dhe dëshminë e vogëlsisë së tij, një provë konkrete që ai nuk ishte hapi final i evolucionit, por vetëm një rast fatlum i të qenit vetëdija e universit. Çka ishte e vogël për njeriun e avionit, ishte gjigante për mua. Çka ishte e vogël për mua, ishte gjigante për një milingonë. Kush kishte të drejtë atëherë të vendoste shtampa rëndësie mbi çdo gjallesë? Njeriu i avionit, mali, unë apo milingona? Mjaftoi një oshtimë e shurdhër nga thellësia e pyjeve përreth të më kujtonte që zoti im për atë natë ishte mali.

Nga ekspedita e vogël që ndërmora u ktheva në çadër pa rënë plotësisht nata. Brenda meje ndjesia intensive që kishte lindur në kafene po ftohej. Yjet kishin filluar të pikëzonin qiellin me një hipnotizim hyjnor dhe nuk u desh shumë që lodhja të lëshonte tentakulat e saj mbi trupin tim. Një gjumë i rëndë ra mbi mua dhe kudo, në çdo pjesë të trupit, kisha ndjesinë se i gjithë mali po binte në të njëjtin gjumë si unë.

Sapo qepallat rënduan mbi sy, një tjetër realitet u shfaq në mendjen time. Dërgova sytë menjëherë te parakrahu i djathtë dhe mungesa e shenjës solli me vete vetëdijen se isha duke ëndërruar.

Vendi ku u shfaqta që tërësisht i panjohur për kujtesën time. Ishte mjedis alien, me kulla të larta jeshile, majat e të cilave lëkundeshin lehtëzi, kodra të formave të çuditshme, disa të shtypura, disa tërësisht rrumbullake.

Një zhurmë prapa meje bëri që të sillja kokën, veprim që e bëra me vështirësi dhe pamja që kaloi pak metra larg meje më shkaktoi drithërima deri në palcë. Një krijesë me gjashtë këmbë, sy të mëdhenj dhe dy antena që i dilnin nga koka si shkopinj të hollë kaloi afër meje, hodhi një shikim të shpejtë dhe, sikur unë të mos ekzistoj fare, vazhdoi rrugën e vet.

Kurioziteti, i mbështjellë me frikë, më shtyu ta ndiqja. Nuk u desh shumë të kuptoja se ecja ime kishte një problem, nuk ndodhte lirshëm, por me ngërç ndërmjet instinktit për të ecur dhe manovrimit të atij instinkti. Gjithsesi, me të bërë dhjetë hapa u ambientova me situatën dhe pas disa minutave, arrita përbindëshin, i cili, përsëri duke injoruar ekzistencën time, depozitoi një sasi uji në njërën prej dhomëzave të gojës, hodhi një tjetër vështtrim nga unë dhe u largua. E ndoqa përsëri, këtë herë duke ecur bregut të atij liqeni dhe në një moment bishti i syrit kapi një antenë mbi mua. Pashë nga mbrapa, por askush nuk ndodhej aty. Pastaj, i frikësuar se mos hamendësimi që kisha në mendje do të dilte i saktë, u përkula mbi ujë. Në fillim u shfaqën antenat, pastaj sytë e mëdhenj të kaftë si dy poça dhe në fund gjymtyrët e holla, të shumta në numër.

Çuditërisht, metamorfoza kishte ndodhur vetëm fizikisht, sepse në brendinë e ndjenjave të mia ndryshimi i vetëm që kishte zënë vend ishte habia ndaj injorancës sime mbi atë mjedis. Hamendësimi i kishte prirë zbulimit dhe, sa hap e mbyll sytë, kullat e gjata jeshile u shndërruan në fije bari, kodrat në gurë të shtypur dhe unë, Jungu, në një milingonë.

Përfytyrojeni veten në një botë përmes së cilës kaloni çdo ditë dhe pa menduar dy herë e konsideroni të mirëqenë dhe pastaj, sa hap e mbyll sytë, kur futeni në të, e gjeni veten në një mjedis tërësisht ndryshe pritshmërive tuaja.

Papritur, nga të gjitha anët filluan të shfaqeshin në marshim qindra mijëra milingona të tjera. Ato ecnin drejt një udhe të paqartë, dukshëm të parrahur më parë, por me anë të ca sinjaleve e gjenin njëra-tjetrën pa vështirësi.

U bëra njësh me turmën dhe ashtu i trembur siç isha nuk mund të mendoja gjë tjetër përveç gjëegjzës se cili do të ishte fundi i kësaj ëndrre. Marshuam për disa minuta dhe sytë filluan të mësoheshin më madhësinë e barit dhe të gurëve.

Dielli ishte më i butë atje poshtë, era të ledhatonte butazi, sikur natyra e ulte presionin e saj në bazë të madhësisë së gjallesës. Çdo mendim që mund të kisha pasur më parë mbi botën aliene të kafshëve të tjera kishte fituar dimensione tërësisht të reja, këndvështrime që e ulnin egon e të qenit njeri në pamundësinë e të qenit milingonë.

Marshimi, që vazhdonte prej disa minutash, ndaloi papritmas, sikur dikush t'i kishte rënë një bilbili, në një shesh goxha të madh, por e dija se po ta shikoja nga sipër me sytë e mi njerëzorë, s'do të ishte më i madh se dy pëllëmbë vend.

Turma e milingonave u rreshtua pa humbur kohë. Secila milingonë kishte një milingonë tjetër në krah. Unë bëra si të tjerët, duke u munduar të mos bija në sy. Nëse diçka e tillë si të rënit në sy mes milingonave ekziston, mendova me vete.

Përpara nesh ngrihej një statujë e madhe, mund të ishte disa herë më e gjatë se trupi i një milingone normale. Qe e lyer me ngjyrë të kuqërremtë, kishte gjymtyrë si shkopinj të trashë, dy antena të zeza pis dhe sy të përhimët, që dukej sikur përqendroheshin përnjëherësh në vëmendjen e të gjithëve.

Papritur, një klithmë u dëgjua nga mesi i rreshtit të parë, e cila nuk vonoi të shoqërohej nga klithma të tjera. I drejtoheshin statujës. Në fillim zërat qenë

të butë dhe të pasinkronizuar, por pastaj fituan fuqi dhe me ndihmën e një koordinatori, që të jepte përshtypje udhëheqësi, gërthitja e tyre u bë një e vetme. Nga secila anë filluan të buçasin ca tinguj që mund t'i identifikojë si daulle. Me një goditje të fortë mbi lëkuren e daulles klithmat shurdhuese u shuajtën njëtrajtshëm dhe ajri u pushtua nga heshtja.

Veprimi që pasoi filloi të rreshti i parë dhe si valë u përçua te rreshtat e tjerë. Me këmbët e para të ngritura në ajër dhe katër të tjerat të ngulura thellë në tokë, ata iu drejtuan statujës me britma të ulëta, por që të rrëqethnin. Diç kërkonin prej saj. Tek po përpiquesha për të hamendësuar se çfarë, kisha harruar se mund ta kuptoja gjuhën e tyre. Gjatë kohës që turma bënte të njohura lutjet, dy milingona u shkëputen nga rreshti i parë dhe bënë drejt statujës. Të mbërthyer në dy gjymtyrët e para, ato mbanin plot kujdes disa shkopinj të hollë. U afruan ngadalë, u përulën përpara statujës, i vendosën shkopinjtë tek këmbët, pastaj akoma me kokën e përulur, u kthyen mbrapa nga kishin ardhur. Klithma e rreshtave vazhdoi përsëri, këtë herë në formë entuziazmi dhe lutjet sa vinin e shtoheshin. Shumica e atyre që luteshin kërkonin lumturi për familjen, begati për fushën, ardhmëri të sigurt për racën e tyre. Por, gjithsesi, kishte nga ato që kërkonin më tepër se atë. Ato nuk luteshin vetëm për racën e tyre, atë të milingonave të Kuqta, por në të njëjtën kohë dhe pa pikë mëshire, kërkonin, me çdo kusht, skamje për milingonat e fiseve të tjera, sidomos për të Gjelbrat, të cilat ishin armiket e tyre të betuara. Lutjet, që filluan të kataklizmoreshin përtej dëshirave të paqta, u mbytën nga bërthimet e pandërprera të atyre që kërkonin luftë, vazhduan për disa minuta të tjera dhe pastaj, rreshtat u ngritën përnjëherësh në të dyja këmbët dhe rituali u quajt i përfunduar.

Shpesh, ndodh të ngatërrohem me veten mbi dilemën se cila ironi është më therëse, ajo e fatit apo e rastësisë, por, kur turma po bëhej gati të shpërndahej

dhe një hije e madhe u shfaq mbi fushë dhe një këmbë njeriu na shtypi të gjithëve pa hezituat, mendoj se rastësia e fiton këtë betejë.

Nga ëndrra u zgjova më lehtë se asnjëherë. Edhe pse më dukej sikur kishin kaluar orë, ndriçimi i fortë i yjeve e tregonte shkoqur se nata qe akoma e re. Hodha xhaketen mbi shpinë dhe dola nga çadra për të marrë pak ajër të freskët. Përreth lëvizte një qetësi e frikshme, një prej atyre që vetëm mali mund ta ketë. Çdo hap që hidhja, e hidhja me kujdes, më shumë si pasojë e ëndrrës sesa nga frika se mos zgjoja të tjerët.

Nga një e dalë buzë një shkëmbi, mbi të cilin u ula këmbëkryq, e kisha qytetin në pëllëmbë të dorës. Dritat e tij luhateshin në ajër me krenarinë e teknologjisë moderne. Sofistikim, ngrohje, siguri. Të gjitha ishin atje, disa kilometra larg atij vendi, i cili, ishte e kundërta e qytetit, me frikën dhe të panjohurën në çdo metër. I ulur në atë copëz shkëmbi, ndoshta dhe si pasojë e ëndrrës, nuk mund të mos mendoja për atë që fshihej pas dritareve. Çfarë ëndrrash ëndërronin? Çfarë lutjesh lëngonin mbi nënkresat e tyre? Për ku niseshin, çfarë synonin? Sepse, në sytë e mi, të gjithë prisnin atë momentin kulmor kur gjithçka do të shpërthente, kur çdo vuajtje do të shpërblehej me triumfin final dhe vraponin e vraponin, godisnin të tjerët me bërryla për të arritur çmimin që i priste atje, në ardhmëri.

Paradoksalisht, pikërisht gjatë momenteve të tilla më vinte ta godisja veten me grusht. Përse? Është si ai eksperimenti social me majmunët. Është si atëherë, kur një eksperimentues vendosi pesë majmunë në një kafaz të madh dhe lart, mbi kafaz, jashtë mundësisë së majmunëve për t'i arritur, ai vendosi një shkallë dhe sipër saj disa banane. Dhe sapo majmunët pikasin bananet, ata bëjnë drejt shkallës dhe kur njëri prej tyre fillon ta ngjisë, eksperimentuesi i lag me ujë, jo vetëm rebelin ngjitës, por dhe majmunët e tjerë poshtë shkallës. Si pasojë majmuni i ndalur në gjysmë të shkallës zbret dhe të gjithë

së bashku ulen të inatosur në dyshtemenë e lagur. Por nuk duhet shumë dhe tundimi i bananeve bëhet përsëri i padurueshëm. Këtë herë një tjetër majmun guximtar fillon të ngjisë shkallën. Eksperimentuesi vazhdon përsëri dhe drejton zorrën e ujit drejt të gjithëve. Pas njëfarë kohe, kur një tjetër majmun përpiket ta ngjisë shkallën, majmunët e tjerë, që të parandalojnë një tjetër qullje, e ndalin ngjitjen e tij dhe fillojnë ta rrahin.

Hapi tjetër i eksperimentit është ndërrimi i një majmuni nga ata të kafazit me një tjetër që nuk ka qenë pjesë e grupit. Sapo i riu vëren bananet, menjëherë niset si i babëzitur drejt shkallëve. Majmunët e tjerë, të alarmuar nga rebelimi i padëshiruar, nisen drejt tij, e ndalin dhe fillojnë ta rrahin. Eksperimentuesi, pastaj, vazhdon me ndërrimet dhe një tjetër majmun i ri bëhet pjesë e grupit të kafazit. Ashtu si me majmunin e parë, i njëjti tundim ndodh përsëri dhe të njëjtin kundërveprim bëjnë majmunët e vjetër, që fillojnë ta rrahin, pjesë e të cilëve tashmë është edhe majmuni i ri që nuk ishte lagur ndonjëherë. Në fund të eksperimentit grupi i kafazit nuk ka në mesin e tij asnjë prej majmunëve fillestarë dhe përsëri, pavarësisht se asnjëri prej tyre nuk ishte lagur ndonjëherë, të gjithë pa përjashtim, si pasojë e rrahjes, kanë frikë të ngjisin shkallën e të marrin bananet.

Tek qëndroja në cepin e atij shkëmbi duke kundruar dritaret e ndriçuara të qytetit, kuptova që ndjesitë e mia nuk ishin dhe aq ndryshe. Ato i ngjasonin atyre të majmunit, që si pasojë e qulljes ka frikë të luftojë për urinë e vet, pavarësisht se nuk e ka provuar asnjëherë lagjen me ujë. Si rrjedhojë, të gjithë më shfaqeshin në atë mënyrë. Por duhet të ndaloja së bëri këdo që shikoja viktimë të rrethanave të tij, sepse ndoshta edhe ata, pas syve të marakotur, fshihnin mendime të përafërta me të miat dhe po ashtu si unë, që më shumë reflektoja sesa veproja, ndoshta të gjithë e dinin se ç'duhej bërë,

por qëndronin në heshtje, duke pritur lëvizjen e dikujt tjetër për të ngjitur shkallën.

KREU 7

Në mal kaluam pothuajse dy ditë të plota. Zbritja ishte e lehtë, ngaqë përveç reve kishim lënë mbrapa edhe mjegullën që kishim pasur përbrenda. U ndjeva i lehtë dhe me atë lehtësi në zemër u ktheva në qytet.

Qyteti nuk më dukej ai i mëparshmi. Nuk prisja ndonjë transformim, por diçka kishte ndryshuar në shikimin tim. Tashmë dhe detajet më të vogla kishin rëndësi për sytë e mi. Kafenetë nuk m'u dukën më aq të zymta, njerëzit qeshnin më shumë, buzëqeshja e tyre qe më e vërtetë. Kishte ndodhur diçka brenda meje, një ndryshim i pavetëdijshëm. Dhe ishte pikërisht kjo metamorfozë shqisore arsyeja e atij ndryshimi të rrufeshëm, intensiv. Ndryshimet e vetëdijshme kanë përherë vetinë të ngatërrohen nëpër rrjetat e dyshimeve.

Ishte mëngjes dhe dielli të përcëllonte. Qielli ishte pa re dhe bluja e hapur, më shume sesa shikimin, të hapte shpirtin.

Para se të shkoja në apartament, mendova të ktheja një kafe të shpejtë. Pi shumë të tilla, siç mund ta keni vënë re, por më shumë doja të takoja Baronin.

E gjeta në vendin e përhershëm dhe si çdo herë po gërricej me një çunak.

Vallë përse punon në këtë kafene, mendova me vete, sapo kalova pragun e derës. Më përshëndeti dhe më ftoi të ulesha te banaku.

Nga magnetofoni i vjetër, i vendosur afër dritares, dilte një melodi kitare. Hodha sytë përreth dhe ashtu si me mua, muzika flirtonte ëmbël me secilin që ndalonte mendimet e tij për të dëgjuar. Një emocion intensiv dilte nga shpirti i atij që luante në kitarë, lëvizte nëpërmjet lëkurës për të mbërritur te majat e gishtërinjve dhe me çdo prekje, dridhja e lëkurës përzihej me atë të telave dhe ajri në kafene nuk kishte ç'të bënte tjetër veçse ta vidhte atë

dridhje nga magnetofoni e ta manifestonte kuptimin e muzikës me universin e zemrave përreth.

Humba brenda asaj melodie derisa mbaroi, pastaj u ktheva nga Baroni, i cili vazhdonte akoma diskutimin e zjarrtë me djaloshin përbri meje.

- Jo, jo, jo! - i thoshte Baroni tërë siguri. - Nuk është mirë të mendosh në atë mënyrë. Është vetëvrasje. Ke provuar ndonjëherë të luash një këngë disa herë rresht? Të njëjtën këngë? Ja, atë melodinë e kitarës që sapo mbaroi. Pavarësisht se ajo mund të jetë muzikë tmerrësisht melodioze, përsëritja e shpeshtë në fund do të të mundë dhe ti do fillosh, në mos ta urresh, të mos e shijosh më. E kupton përse përjetësia është mendim kaq i rrezikshëm? Kush dreqin do të dëshironte të jetonte përjetë? Vetëm të çmendurit. Ose ata që s'ia kanë idenë ç'flasin. Jeta duhet të mbarojë. Përndryshe do ta urrenim.
- Por cili është kuptimi i diçkaje që lind dhe në mënyrë të pashmangshme pret që të vdesë? - ia kthente djaloshi, i shtangur nga ajo që dëgjonte.
- Kuptimi? Besoj që ka vetëm një. Ekziston vetëm e tanishmja. Dhe që ti ta shijosh, që t'i japësh kuptim vdekjes njerëzore, duhet që ta përdorësh mirë të tashmen tënde. Çdo të tashme.

Në mendjen time sillej akoma mendimi fillestar.

- E si dreqin ta bëj? - pyeti djaloshi.
- Mendon se ekziston një përgjigje absolute? Se ka vetëm një mënyrë dhe, o burra, hajde ta jetojmë të gjithë?
- Jo, do të ishte tepër arrogante kjo gjë.
- Atëherë?
- Atëherë, të paktën dua të di në ekziston një mënyrë si të hyj në botën e mundësive për ta bërë diçka të tillë.

- Të lexosh, ndoshta? E ke menduar më parë?
- Po, por ka kaq shumë libra. Kaq shumë mendime, opinione, filozofi. Si ta di se cila është ajo që më drejton aty ku dua?
- Drejt ç'gjëje do që të drejtohesh?
- Drejt të vërtetës sime.

Baroni humbi për disa sekonda në mendime.

- Qëndrojmë te muzika. Ke ndonjë këngë të preferuar?
- Sigurisht.
- Kur e ke zbuluar që ajo të pëlqen më shumë se të tjerat?
- S'e mbaj mend.
- Nuk e kam fjalën për aspektin kohor. Dua të them, ke dëgjuar këngë të tjera para se ta zbuloje atë këngë?
- Natyrisht që po.
- Ja, kjo është përgjigjja.
- Nuk po të ndjek.
- Shiko. Përpara se të gjeje këngën tënde të preferuar, ti ke dëgjuar me qindra këngë. Ke dëgjuar melodi nga më të çuditshmet, melodi që të janë fiksuar për dy ditë e pastaj i ke harruar, melodi që në notën e parë të kanë krijuar antipati, fjalë që kanë qenë manifestimi i plotë i gjendjes tënde emocionale dhe ti ke menduar se ndoshta ajo ishte kënga jote. Por pastaj gjendja jote ka ndryshuar dhe kënga e ka humbur kuptimin e mëparshëm. Ndodh kjo gjë: të kemi iluzione të përhershme për gjëra të përkohshme. Pastaj, një ditë ti je takuar me një melodi ndryshe, një melodi që luan me të njëjtën shpejtësi të shpirtit tënd, të mendimeve të tua. Muzikën që zemra këndon kur telat e realitetit luajnë me ndjenjat e tua. Dhe sado kohë që ka kaluar, sado kohë që kalon, ajo melodi është përherë aty, e pandryshueshme përballë stuhive të zhgënjimeve, e

palëvizshme kundrejt erës së kohës që vyshk çdo ndjenjë. Kjo është përgjigja jote. Duhet të provosh përgjigje të vakëta, zhgënjyese, të paplota dhe iluzionare përpara se të gjesh atë që rreh me rrahjen e zemrës tënde.

Nofulla e djaloshit kishte rënë përtokë dhe jam i sigurt se edhe ai, ashtu si unë, po çukiste veten më të njëjtën pyetje. U bë gati ta kthente atë mendim në fjalë, por Baroni sikur e nuhati dhe u kthye nga unë.

- E solle kokën, ë? Nga ke humbur kështu? Ka dy ditë që s'të kam parë. Je kthyer më në fund në shkollë?
- Jo, jo. Diçka më të mirë. Kam ngjitur një mal.
- Një mal?
- Po.
- E dëgjove?

Mendova se iu drejtua djaloshit, por vendi i tij ishte boshatisur dhe kuptova që pyetja ishte për mua.

- Çfarë të dëgjoja? - e pyes, i habitur.
- Zërin e malit.
- Mali ka zë?
- Ka që ç'ke më të. Është gjëja më e afërt që mund të dëshmosh mbi marrëdhënien tonë me natyrën.
- Fatkeqësisht jo, nuk e kam dëgjuar.
- Do ta dëgjosh. Gjithçka që ikën një ditë kthehet e kur ajo ndodh, e kthyer ka një formë ndryshe të ikurës. Sikur ndodh një metamorfozë. Ikja është gjithmonë e njëjtë, kthimi përherë i ndryshëm. Dhe tek shikoj sytë e tu, mund të them se kthjelltësia në ngjyrën e tyre ka ndryshuar paksa. Nuk janë më të mjegulluara si më parë.

U mata t'i bëj pyetjen që djaloshi nuk kishte mundur, por Baroni e nuhati përsëri dhe u largua me justifikimin për të pastruar makinerinë e kafesë.

KREU 8

Po luaja me fletët e ditarit, kur papritur mbi tavolinën përballë sytë më zunë një pjatë me mollë. Nuk kisha uri, por diçka gurgulloi brenda meje. Nuk u desh shumë që, si në ëndërr, të më fanitej biseda mbi teorinë e Platonit, të cilën ajo ma kishte përmendur pak ditë para se të largohej.

U shfaq përsëri afër dritares me shikimin diku përtej.

- Ke dëgjuar për teorinë e Platonit mbi shpirtin binjak?
- Jo, - ia kthej unë. Kisha dëgjuar disa pjesëza, por nuk kisha qenë dhe aq i interesuar.
- Sipas tij, - vazhdon ajo, - njerëzit e parë qenë qenie perfekt. Kishin katër krahë, dy sy para kokës, dy sy mbrapa kokës, katër këmbë, me një fjalë, ishin krejt të plotë. Ngaqë Zeusi, dihet, kishte tipare mjaft njerëzore, pas njëfarë kohe u bë xheloz për lumturinë e tyre dhe vendosi t'i ndajë. Që atëherë, vazhdon teoria, njerëzit sillen rreth botës për të gjetur gjysmën e tyre të vërtetë. Dhe sigurisht, dashuria është atributi kryesor i ribashkimit të dy shpirtrave. Ky, mund të thuhet me njëfarë sigurie, është një ndër mitet që me kohën është shndërruar në të vërtetën absolute të çdo njeriu në kërkim të gjysmës së tij. Ndoshta ja përse e urrej paksa si koncept. Ngaqë është kaq përgjithësues.
- Ke ndonjë alternativë tjetër?
- Ja ta marrim për një moment këtë teori si të mirëqenë. Sikur e kemi një njeri të tillë në mesin tonë. Dy qenie të bashkuara në një që askush s'mund t'i ndajë. Dhe dashuria, siç thotë miti, është strumbullari i fatmirësisë së tyre. Ajo që më fut përherë në mendime është kjo: po kuptimin përse nuk e përmend kush? Përse mirëkuptimit ndërmjet tyre i vendoset kaq pak rëndësi? Si merren vesh me njëri-tjetrin nga t'i hedhin katër këmbët? Si i hedhin shikimet përtej horizontit të tyre,

nëse botëkuptimet i kanë të ndryshme? Si e diferencojnë armikun nga miku, kur miku për njërin është armik, ndërsa armiku për tjetrin është mik? Si munden të ndajnë të njëjtin mendim, nëse çdo e vërtetë e re që zbulohet kuptohet ndryshe nga secili? Si munden katër sy të shikojnë diçka dhe të bërtasin përnjëherësh të njëjtën gjë, nëse dashuria është e vetmja që i bashkon?

- Pra, ti thua që dashuria nuk mjafton?
- Jo, nuk mjafton! Më shumë se të duhem, unë dua të kuptohem! Ti mund të më kundërshtosh, të më mohosh a çfarë të duash, por si fillim, kuptomë. Dashuria, nëse është e vërtetë, vjen si rrjedhojë e saj. Është sikur të ndash një mollë dhe njëra nga gjysmat të dashurohet me një gjysmë limoni. Ndodh. Dashuria nuk njeh shije. Por tregomë, do e kuptonte molla thartësinë e limonit? Do e pranonte limoni ëmbëlsinë e mollës?
- Do ta dashuronte.
- Me siguri. Do mësoheshin me ngjyrat e njëra-tjetrës e në fund do pranonin çdo ndryshim. Por pastaj do kalbeshin, duke mos e kuptuar asnjëherë se çfarë shije ka dashuria e tyre. Të dashurosh pa kuptuar atë që dashuron do të thotë të mësohesh me një shije që nuk ke për ta provuar asnjëherë të plotë. Të kuptosh do të thotë të provosh të plotë një shije që s'ke përse ta dashurosh. Dhe ne s'duhet të dashurojmë këdo. Një mollë nuk ka përse të dashurojë çdo limon, çdo portokall, çdo qershi. Por mund t'i shijojë, t'i kuptojë. Dhe vetëm atëherë, vetëm kur e di shijen e të tjerave mund ta gjejë gjysmë mollën tjetër. Njerëzit duan ta dashurojnë shijen tënde, jo ta shijojnë atë!

Kujtimi mbaron me kaq. Sado që mundohem t'i kujtoj fjalët apo veprimet e mia pas atij momenti, ndjesia që ato kanë lënë mbrapa e mjegullon kujtesën time dhe nuk i lejon të dalin në sipërfaqe.

KREU 9

Atmosfera në kafene filloi të plogështohej dhe si pasojë më kaploi një përgjumje e lehtë.

Ëndërrova përsëri dhe këtë herë u shfaqta përpara një shtëpie dykatëshe, që ngrihej si lapidar frike në mes të natës. Qe e vjetër, e lyer në një mënyrë të atillë që ngjyra e theksonte lashtësinë e drurit dhe përreth, duke i ndarë dritat e rrugëve në gjysmë, pluskonte një mjegull e dendur. U afrova te porta dhe mbi të, me kaligrafi po të vjetër, shkruhej: “Shtëpia e Kënaqësisë”. Shuli i derës që i gdhendur me metal të ndryshkur dhe mbi të mund të dallohej qartë fytyra e një djalli të vogël. Trokita me forcë të imponuar nga frika e asaj që mund të dilte nga pylli mbrapa meje dhe ashtu, duke u dridhur nga i ftohti, prita për disa momente. Përtej derës nuk dëgjohej asnjë lëvizje. E përsërita veprimin, por përgjigja ishte heshtje, që duke marrë parasysh rrethanat ku ndodhesha, ishte mjaft e frikshme.

U përpoqa t'i kujtoj vetes se ishte thjesht një ëndërr, por përsëri ato janë aq reale sa nganjëherë harroj, nëse ndodhem me të vërtetë në realitetin e njëmendtë apo në gjumë.

Prita një tjetër minutë dhe u bëra gati të ikja, kur papritur një boshllëk u krijua në derë dhe nga errësira pas derës u shfaqën dy sy.

- Fjalëkalimi? - thanë sytë.
- Hëm... “Shtëpia e Kënaqësisë”, - thashë, duke mos ia pasur idenë se pse zgjodha pikërisht atë togfjalësh, nga frika apo nga shpresa që e vërteta mund të më fshihej para syve.

Për çudinë time porta u hap dhe para meje u shfaq një trup i lakuriqtë, veshur vetëm me mbathje të zeza dhe pardesy të gjatë të hedhur mbi supe. Fytyrën ia mbulonte errësira, por drita e syve të saj flakëronte qartësisht dritë epshi.

Me një lëvizje dore si të magjistarëve ajo më ftoi brenda dhe figura e djallit u zhduk sakaq në errësirën mbrapa meje. Përpara nesh në të dyja anët e korridorit kishte dyer me kanate të hapura, por njëra në veçanti, prej së cilës dilte një aromë ndryshe djersës sime plot frikë dhe kuriozitet, më tërhoqi pas vetes.

U afrova te dera nga vinte aroma dhe tentova të hyja brenda, por menjëherë, duke mos më lejuar të hedh asnjë hap, e panjohura mbrapa meje më kapi nga beli dhe më ktheu me fytyrë nga ajo. Nga të brendshmet ajo sajoi një pëlhurë dhe pa hasur kundërshtim prej meje m'i mbuloi sytë. Bëra të them diçka, por gishti i saj u vendos menjëherë mbi buzët e mia dhe ashtu, me gojën e mbyllur, më tërhoqi brenda dhomës.

Aty ajri ishte më i ngrohtë dhe përreth dëgjoja rënkime nga më të ndryshmet. Disa vinin nga kënaqësia, disa nga dhimbja, por nuk dija të dalloja se cilat ishin më të ethshmet. Dora që udhëhiqte më lëshoi mbi një divan të lëkurtë dhe ngaqë kurioziteti po më brente nga brenda, instinktivisht ngrita dorën për ta hequr pëlhurën nga sytë, por, menjëherë, një prekje më ndaloi.

Anash ndjeva prani të tjera. Gërvishtjet mbi lëkurën e divanit më krijojnë ndjesinë e tigrin përpara se të hidhet mbi prenë. Disa thonj filluan të luanin me lëkurën time dhe trupi kaloi në ekstazën e mornicave. Pak nga pak duart u ngjitën më lart, duke lënë mbrapa vijëzimet e presionit që kishin ushtruar mbi lëkurë. U ndalën mbi buzë. Një kafshim më bëri të lëshoja një rënkim, të cilin u përpoqa ta gëlltis, por dhimbja ishte e madhe. Gishti që po lëvizte mbi buzën time të epërme u njetos me gjakun që po rridhte dhe filloi ta shpërndante në pjesën e palagur të buzëve. Pastaj gishti u zëvendësua nga

diçka më e butë që më bëri të dridhesha gjer në palcë. Buzët e mia u bashkuan me buzë të tjera dhe një dorë lëvizte mbi sy. Pëlhura e zezë ra në tokë dhe sytë e mi dihatën të çliruar.

Pardesynë e kishte hedhur tutje dhe mbi të lëngonin vetëm të brendshmet e zeza. Sytë i shkëlqenin nga reflektimi i qirinjve përreth, njëren këmbë e kishte vendosur mbi divan, duke e përthyer trupin drejt meje. Ngjyra e epshit në sy ishte intensifikuar. Mbi mua lëviznin akoma duart e tjera. Ktheva kokën. Në të djathtë më priste Magda me këmbët e kryqëzuara. Vagina e saj ishte lagur. Në sy i lexohej dëshira e ethshme për hakmarrje. Një tjetër dorë lëvizi mbi shpinë. Ktheva kokën. Një tjetër vaginë e lagur u shfaq në lakuriqësi përpara meje. Qe Anzela. Me sy, ajo pikturonte në ajër të njëjtën dëshirë si Magda, të hakmerreshin përnjëherësh. Ajo, e cila qëndronte përballë meje pa ma hequr shikimin, lëvizi dorën mes flokëve të gjatë dhe vendosi njëren këmbë mbi penisin tim. Rënkimeve përreth, që vetëm shtoheshin, iu bashkua dhe rënkimi im. Kjo vetëm për një moment të shkurtër. M'u krijua një ndjesi marrakotjeje dhe pështirosjeje, sikur ato po më mashtronin drejt një loje tallëse, një marrje haku të padrejtë. Nuk isha fajtor!

Dola nga “Shtëpia e Kënaqësisë” me shpejtësi, duke lënë prapa imazhet e zhveshura të femrave të jetës sime. Papritur ndjeva se kisha nevojë për të pirë. U solla nëpër atë vend të panjohur derisa rastisa në një lokal nate. Hyra brenda. Vendi që i vdekur. Një banakier, që të jepte përshtypjen e një somnambuli, po pastronte disa gota. Në banak i bënin shoqëri disa pijanecë. U ula në fund të tryezave dhe porosita një pije.

- Verë? - ma ktheu e habitur kamerierja kur i dhashë porosinë. Ishte një grua në mesomoshë, me një trup që mjaft të reja do ta kishin zili.
- Sa vjeç je?

- Mjaftueshëm për të pirë ç'të dua, - ia ktheva unë. Ajo iku, në dukje qejfprishur, dhe u kthye pas dy minutash me pijen time në dorë.
- Nuk të kam parë këtej rrotull më parë. Je i ri në këtë qytet?
- Po.

Përgjigjja ime e prerë nuk i pëlqeu. Dukej që kishte nevojë për bashkëbisedim, por nuk isha në qejf për të folur. Isha shteruar nga energjitë. Piva gjysmën e gotës me shpresën se do të rifitoja ngjyrën e humorit dhe fatmirësisht vera më solli paksa në qejf. Sytë e kamerieres më ndiqnin në çdo moment, por për çudi nuk e kisha dhe aq bezdi. Kënaqësia e të qenit objekt interesi është diçka që nuk mund të neglizhohet. Por pas disa minutash ai interes u bë i bezdisshëm. Ndjeva tek më merrej fryma. Privatësia ime po cenohej. I hodha një shikim të egër dhe ajo ktheu kokën nga ana e kundërt. Mendova se e kisha hequr qafe, por u deshën vetëm pak sekonda që të më shfaqej para syve.

- Sa vjeç je?
- Më pyete njëherë.
- Nuk më intereson të bej seks me ty, djalosh. Je tepër i imët për mua. Dhe më duket se gjithashtu je tepër i vogël për të pirë alkool. Ke kartë identiteti?

Instinktivisht futa dorën në pjesën e brendshme të xhaketës. Portofoli ishte aty. Hodha një shikim të shpejtë te karta e identitetit. Vendlindja: Shqipëri. Mosha: 20.

- Nuk e tregon moshën, - tha ajo pas disa momentesh hetimi. - Herën tjetër mos u rruaj. Heq dyshimet dhe ke më shumë sukses me femrat.

E mora kartën nga dora e saj dhe e futa bashkë me portofolin përsëri në xhaketë.

- Ç'do të bëje nëse do të isha më i vogël?
- Asgjë. Isha thjesht kureshtare.
- Hëm... Në rregull.
- Shqipëria. Ku i bie ky vend?
- Brenda dëshirave dhe jashtë ëndrrave, - i them unë, duke e kthyer gotën me fund. - Tani, nëse mundesh, sillma një uiski.

Isha zhytur në qetësi, kur papritur heshtja u prish nga ngritja plot zhurmë e një perdeje pas banakut. Një skenë u shfaq pas saj dhe nuk vonoi shumë që nga errësira të dilte një zë.

- Të nderuar zonja dhe zotërinj, - thirri zëri plot fuqi. Hodha shikimin përreth, për të parë se kujt i drejtohej, por sytë, peshën e të cilëve mund ta ndieja mbi supe që pas perdes së errësirës, rëndonin vetëm mbi mua.

Ai vazhdoi:

- Vëmendjen këtu, ju lutem! Historia që do të rrëfej këtë natë është një histori ndryshe, ku mënyra a shkaku se si personazhet e saj janë takuar nuk përbëjnë ndonjë interes të veçantë. Kurioziteti juaj duhet të qëndrojë vetëm te biseda që ndodh si pasojë e atij takimi. Kështu që, le të fillojmë pa humbur kohë.

Si nëpër ato shfaqjet e magjisë, prezantuesi, nga pas errësirës, lëshoi dorën me fuqi drejt dyshemesë dhe një re tymi lindi mbi skenë. Nuk u desh shumë që tymi të zbehej dhe pas tij të shfaqej një tavolinë me katër veta ulur rreth saj.

Zëri i prezantuesit trazoi ajrin përsëri nga diku pas skenës.

- Një budist, një politikan, një fetar dhe një astronom qëndrojnë rreth asaj tavoline. Një dorë ngrihet në ajër dhe kamerieri ia beh sakaq te

këmbët e tyre. Katër birra porositen. Katër birra mbërrijnë. Katër gota mbushen. Vetëm dy kthehen.

Fjalët e fundit qenë si fëshfërimë ere.

Tavolina filloi të gjallërohej dhe nuk vonoi shumë që biseda të fillonte.

- Akoma ju me këtë historinë e pijes? - nuk ndenji dot politikani (secila karrige kishte të stampuar rolet përkatëse) pa ngacmuar fetarin dhe budistin.
- Ndryshe nga ju politikanët, - kërceu fetari menjëherë, - ne i marrim shkresat në mënyrë absolute. Vetëm kështu mund ta dallosh të mirën nga e keqja.
- Absolute? - tha budisti duke hapur sytë me habi.
- Ndryshe nga parafolësi, unë nuk pi, për arsyen e vetme se gjithçka është relative.
- Relative? - ia kthen fetari me nënqeshje. - Ç'do të thuash me këtë? Kjo s'ka fare kuptim.
- Pikërisht, - përgjigjet budisti. Fytyra e tij qëndronte e qetë, sikur brenda tij nuk lëngonte asnjë ndjesi.
- Ju jeni të çmendur, ja çfarë jeni, - foli astronomi. Kishte ndenjur gjithë kohën duke parë sa nga njëri te tjetri. - Ne po pluskojmë në hapësirë mbi një top shkëmbi dhe ju refuzoni të shijoni një gotë birrë? Patetike!
- E para, topin ka se kush e mbron. E dyta, refuzimi i dëshirave është prova që unë e meritoj shëlbimin, - tha fetari me mburrje.
- Meriton? - kërceu budisti - Ju keni një kuptim krejt të gabuar të karmës, e dini?
- Ndërsa ti as që ia ke idenë se çfarë thua, - foli politikani. - Karma është një iluzion i shprehur ndryshe, por i njëjtë me idenë e një jete të përtejme. Rritni ca këllqe.

- Aty të rri mendja ty, te gjërat që të mungojnë, - foli me përbuzje fetari.
- Do të vijë dita që do e kuptosh, por do të jetë vonë.
- Vonë? - tha politistani me përqeshje. - Sikur shkresurinat tua e njohin pendesën edhe në shtrat të vdekjes?
- Ha-ha, pra ti je dakord me mua? - Një dritë shprese u shfaq në sytë e fetarit.
- Ironi, i dashur. E njihni këtë shkresë ju të fesë?

Drita e shpresës u zbeh drejt asgjësë.

- Mjaft me lojëra fjalësh tani, - foli astronomi për të dytën herë. - Këto gjëra mund të zgjidhen racionalisht, objektivisht, ashtu siç i ka hije qenies njerëzore.
- Foli ky, - kërcëu fetari. - Ju që ndërtoni bomba atomike për të shpjeguar racionalitetin tuaj.
- Kjo nuk është fare e vërtetë. Shpikjet nuk mund të ndalohen thjesht sepse disa grupe mund t'i përdorin ato për të plotësuarat dëshirat personale që u dikton egoja. - Sytë e tij kaluan drejt politikanit.
- Foli ky i teorive. Keni zbuluar ndonjë alien këto kohë? - ia ktheu politistani me tallje.
- Nëse ju politikanët do t'i përdornit fondet për gjëra më të vlefshme dhe jo vetëm për financimin e fushatave tua, atëherë ndoshta do mund të zbulonim ndonjë gjë.
- Blasfemi, - tha fetari.
- Të gjithë jemi një, - foli budisti.
- Në fakt, të gjithë jemi alienë, - ua ktheu astronomi. - Teknikisht jemi alienë ndaj vetes, nuk njohim as shumicën e gjallesave të oqeanit akoma. Vetë toka është aliene për ne.

- Atëherë përse kërkoni fonde që të kundroni qiejt? - shfryu politikani duke përfitur nga rasti.
- Sepse duke studiuar atë që është jashtë, mund të përmirësojmë atë që është brenda, - ia ktheu astronomi i sigurt në vetvete.
- E di ti se nga e kemi zbuluar efektin serë? Duke studiuar atmosferën e Venusit. Po ashtu dhe ngrohjen globale, duke studiuar historinë milionavjeçare të klimës sonë.
- E vetmja gjë që do ta shfarosë tokën, - foli fetari duke përfitur nga tema që u shpalos nga shkencëtari, - është ndëshkimi i atij lart mbi mëkatarët.
- Ti s'ia ke idenë se çfarë thua, - kërcëu astronomi i irrituar. - Në hapësirë nuk ekziston diçka si lart apo poshtë. Vetë mënyra si flet, tregon shkoqur që s'ia ke idenë se si universi funksionon.
- Por di se si funksionon qenia njerëzore. Dhe ajo është e rënë. Dhe duhet të udhëhiqet.
- E vetmja gjë që qenia njerëzore duhet të bëjë, - foli budisti pas shumë momentesh qetësie, - është që thjesht të ekzistojë. Kaq mjafton.
- Thjesht të ekzistojë? - ngriti zërin politikani. - Je i çmendur gjë? Gjithë këto mrekulli rreth nesh dhe ne të mos i përdorim?
- E vërtetë, - tha astronomi. - Në njëfarë mënyre duhet ta mbrojmë Tokën nga meteorët.
- Përse? - tha budisti. - Siç dhe kemi ardhur në ekzistencë, ashtu dhe do të ikim. Majmuni u ngrit në këmbë, por mund të ngjitet përsëri në pemë.
- A të keqen e gjëegjëzave, - foli politikani duke qeshur. - Kujdes mos përmend majmunë këtu. - Dhe ktheu kokën me ironi nga fetari.
- Në fakt, - kërcëu menjëherë astronomi. - Majmuni është vetëm një fazë e vonë e evolucionit. Mund të flasim dhe për pemët, ADN-ja e të cilave

është fundamentalisht e ngjashme me tonën. Në njëfarë mënyre, ne jemi natyra po aq sa natyra është ne.

- Ne jemi natyra, aq sa Zoti na lejon të jemi natyra, - tha fetari i nervozuar. - Ç'është kjo blasfemi? Ne, të njëjtë me pemët? Me mikrobet, a ç'dreqin studioni ju atje nëpër laboratorë? Kjo është patetike!
- Ndërsa të dalësh nga balta dhe të të fryjnë për të dhënë jetë është krejtësisht e pranueshme, ë? - ia ktheu astronomi me po të njëjtin nervozitet.
- Qetësohuni djema, - foli politikani.
- Këto janë tema delikate. Kërkojnë studim dhe në të njëjtën kohë këqyrje të tërthortë që asnjëra palë të mos ofendohet.
- Ofendohet? Ore, je në vete ti? Nëse censurohemi thjesht sepse një palë ofendohet atëherë më mirë të kthehemi në mesjetë.
- Në mesjetë jemi akoma, - foli budisti. - Njohuritë mbi fuqinë tonë të brendshme janë kaq sipërfaqësore. Në njëfarë mënyre, jemi akoma në epokën e gurit.
- Ti censuro, a mos censuro ç'të duash, - tha fetari qetazi. - Thjesht mos guxo të ofendosh besimin tim.
- Besimin tënd s'ka nevojë ta ofendojë kush, nëse e mban vetëm për vete. Problemi im fillon tek momenti që ti e fut në politikë, - kërceu politiku.
- Dhe për tepër, - i ndërpreu astronomi, - feja është një ide, një mënyrë jetese, nuk është një racë. Kështu që, mëso t'i ndash nga njëra-tjetra.
- E bardha ka nevojë për të zezën që të ekzistojë, - foli fjalëpaku budist. - Si do e dije ti të vërtetën tënde, nëse nuk do dije gënjeshtren e tjetrit?
- Ja përse fjala e Zotit është e vërteta. Është absolute. Ndërsa ju politikanët e shkencëtarët, një zot e di se sa gabime që bëni.

- Po ky është dhe sekreti i diçkaje që punon, o kopuk. Kjo është shkenca. Mekanizmi i gabimit është ai që të dërgon drejt një të vërtetë objektive, duke përjashtuar influencat e njerëzve subjektivë si ti, që nuk mund të rrinë dot pa futur hundët në zbulimet që dalin kundra iluzioneve të tyre.
- Shiko, - tha politikani, - premtimet e shkencës dhe të fesë janë pak a shumë të njëjta. Të dyja duan të përmirësojnë jetën e njerëzimit.
- Njëra e përmirëson atë praktikisht, - ia bëri astronomi, - ndërsa tjetra e bën të ndihet fajtores për ekzistencën e vet. Dhe jo, s'jemi askund e njëjta gjë. Fesë i mungon laboratori.

Papritur ia behu përsëri kamerieri tek këmbët e tyre.

- Zotërinj, ju lutem. Kemi marrë ankesa për zhurmë që vjen nga tavolina juaj.
- Kërkojmë ndjesë, - foli si me ngutje fetari. - Keni të drejtë.
- Uau, - tha aty për aty astronomi. - Ti duke i dhënë të drejtë dikujt?
- E drejta nuk ekziston, - kërcëu politikani sikur ta kishin prekur në tela. - Ekziston vetëm interpretimi që i bëjmë të vërtetës.
- Sigurisht, sigurisht, - filloi astronomi duke qeshur. - Ja përse sot, në botë, fiton ai që di të debatojë më mirë dhe jo ai që ka të drejtë. Patetike! Një plus një bëjnë dy edhe nëse ty të bëhen sytë sa një poç.
- Filloi prapë ky, - shfryu politikani. Pastaj shtoi: - Por përsëri, ajo mbledhje matematike është e arbitruar nga ju shkencëtarët.
- Dhe këtu fillon keqkuptimi juaj, - tha astronomi. - Numrat nuk i kemi shpikur, i kemi gjetur në natyrë. Ata janë rrjedhojë e studimit të natyrës. E di ti se ka pasur dështime misionesh në hapësirë, vetëm nga një keqkonvertim i sistemit të miljeve në atë metrik. Kjo është një provë e pakundërshtueshme, që nëse një plus një bëjnë dy, atëherë natyra nuk

pranon konvertim të së vërtetës në interpretime siç i duam ne. Ja përse feja, dhe më duhet me keqardhje të fus dhe filozofinë në këtë mes, nuk arrijnë më larg sesa universi që i diktojnë vetes. Por imagjinata e universit është më e pasur se ajo e njeriut. Edhe pse ka ca grupe që nganjëherë pëlqejnë ta sfidojnë. - Dhe menjëherë kaloi shikimin te fetari.

Budisti qëndronte në heshtje. Nganjëherë mbyllte sytë si në shenjë keqardhjeje, por pastaj i hapte kur dëgjonte ndonjë fjalë që i jepte shpresë. Ishin fjalët e shkencëtarit ato që ia hapën sytë këtë radhë.

- Ja t'i bëj një pyetje shokut tonë budist, - vazhdoi astronomi duke iu drejtuar fetarit. - Zoti budist, çfarë ndodh me besimin tuaj, nëse një zbulim shkencor e hedh poshtë një hallkë të tijën?
- E thjeshtë, - tha budisti qetazi. - Besimi im do të duhej t'i futej një ndryshimi. Është e pakonceptueshme të jetosh në një univers që t'i jep përgjigjet në bazë të studimit të tij dhe t'i kundërshtosh ato. Por përsëri, duhet ta pranoni që disa pyetje nuk kanë përgjigje. Ja përse duhet që të shikojmë brenda. Nirvana është vendi ku gjenden përgjigjet. Nuk mjaftojnë teleskopët.

Fetari psherëtiu. Astronomit i shkëlqyen sytë. Politikani seç kërkonte me sy. Tentuan ta vazhdonin bisedën, por një zhurmë shurdhuese mikrofoni ua vërdhi vëmendjen drejt skenës qendrore.

Zëri pëshpëritës u shfaq përsëri.

- Të nderuar zonja dhe zotërinj! Historinë e sotme, fatkeqësisht, detyrohem ta lëmë përgjysmë. Një artist është vetofruar që të pikturojë përpara nesh, në kohë të vërtetë, ndryshe prej herëve të shumta të tij, kur na tregon mënyrën se si ai koncepton universin, pra, këtë herë, nuk

do të na tregojë realitetin e botës së tij, por realitetin e botës sonë. Këtej ju lutem, zoti artist, në qendër. Ja aty, ku të gjithë mund t'ju shohin. Aty, po. Me endje po presim historinë tuaj.

Ishte një burrë i vjetër, me pallto të vjetër ushtrie të hedhur mbi krahë. Vëmendja e aktorëve në skenë qëndroi e patrazuar, ndërsa e imja ndiqte artistin me pallto ushtrie në çdo lëvizje. Dhe sikur ta kisha pritur, sapo artisti vendosi penelin në telajo, skena u ngatërrua me vetveten dhe unë u transportova në një ëndërr tjetër.

Zhurma e një shpërthimi të madh më solli menjëherë në vete. Hodha sytë përreth. Një tjetër bombë shpërtheu mu para meje. Ngado fluturonin plumba, kumbonin sirena. Gjeografikisht ndodhesha në një godinë të vogël, muret e së cilës qenë ngrënë nga mortajat. Hodha hapin e parë jashtë atij katrori mbrojtës, të kuptoja më mirë gjendjen jashtë, por plumbat më kthyen mbrapsht me shpejtësinë e lepurit. Ndodhesha në mes të një lufte.

Doja të ikja nga ai vend, por brenda meje gurgullonte kurioziteti. Duke u munduar t'u shmangesha plumbave, arrita të dilja nga burgu i përkohshëm. Me vrap arrita tek një bunker, brenda të cilit u hodha me gjithë trup mbi një thes me rërë. Fryma gati sa s'po më merrej, jo më shumë nga vrap, sesa nga frika se çfarë më priste. Hapa sytë fort që të shquaja një pamje me të qartë. Bunkeri që më i vogël seç e kisha menduar. Brenda ndodhej një burrë me shtat të vogël që po dhatej në cepin e kundërt dhe po më zhbironte me sytë që i kishin humbur brenda zgavrave. Në ajër lëvizte një lagështi vdekjeje.

- Kundër kujt jemi duke luftuar? - e pyes unë, pa menduar dy herë pasojat që mund të kishin ato fjalë. Ai nuk i dha shumë rëndësi asaj që dëgjoi dhe, duke ngritur pakëz syrin, për të kapur siluetat që lëviznin jashtë, tha:

- Mjafton të dish se je duke luftuar për jetën tënde. Ajo është rëndësia e vetme që duhet të rëndojë në ndërgjegje, djalosh.
- Pra, sado njerëz që unë të vras, ato vrasje janë të justifikueshme nga fakti i thjeshtë që unë jam duke i vrarë që ata të mos më vrasin?
- Po, - ia bëri ai dhe u kthye në pozicionin e mëparshëm.
- Nuk ka ndonjë zot kjo luftë, ndonjë të drejtë, ndonjë që e di përse po ndodh gjithë kjo tragjedi?
- Gjaku nuk do t'ia dijë për të drejtë, - ma kthen ai, në dukje më i qetë. Shpërthimet kishin filluar të rralloheshin. - Kur sytë e burrave shohin gjak, e vetmja gjë që ka rëndësi në ato momente është që të mos jetë i tyre. Të tjerat janë politike e pasluftës që ushtarët e thjeshtë si ne as do ta kenë privilegjin për t'i dëgjuar. Do të kemi vdekur deri atëherë. Në mos nga plumbi, nga çmenduria.

Fjalët e tij peshuan si bombë mbi mua. Shpërthimi që i ngadaltë, kërkonte të dëshmoja tmerret që njeriu i bënte njeriut për një vogëlsirë egoje, një çikërrimë krenarie apo pasioni të verbër për pushtet. Por pastaj, pak nga pak, jehona e shpërthimit u vënit dhe muzika e fundit e vdekjes së ngadaltë më solli ne vete, duke kënduar nën zë këngën që më thoshte se ëndrrat ishin po aq të vërteta sa dhe jetët që nuk i jetonim.

- Mendon se ka një jetë të përtejme? - e pyes.
- Ke ardhur në vendin e duhur. Këtu ke bileta për radhët e para të shfaqjes.
- Duhet, apo jo? Të ketë një tjetër jetë? Përndryshe ç'kuptim do të kishte?!
- Kush tha se duhet të ketë kuptim?

- Unë! Ne! Të gjithë! Dua të them, shiko përreth. Gjithë kjo vuajtje duhet ta ketë një shpërblim, apo jo? Përndryshe gjithçka do qe e kotë. Gjithë ky gjak! Gjithë ky tmerr! Gjithë kjo pafajësi!
- Dhe kush e thotë këtë, djalosh? Kush i jep rëndësi e kuptim fjalëve që sapo the?
- Hm... - ia bëj, i zënë në grackë. - Njerëzit?
- Njerëzit! Ne! Ne i bëjmë të gjitha. Ne i krijojmë të gjitha. E ç'rëndësi ka nëse një jetë e përtejme ekziston? Nuk e kemi një? Nuk jemi duke e shkatërruar këtë që e dimë me siguri që e kemi? Përse na duhet dhe një tjetër? Ta shkatërrojmë dhe atë? Përse ekziston lufta djalosh, më thuaj?
- Të mirët luftojnë të këqijtë, - përgjigjem unë.
- Dhe kush duhet të fitojë?
- Të mirët, sigurisht.
- E cilët janë të mirët?
- Të mirët janë ata në anën e të cilëve jam duke luftuar. Përndryshe nuk do të isha duke luftuar për ta.
- Por ti nuk e di se në cilën anë je, harrove?

Fytyra ime mori pamjen e një jehone që i merret fryma. Ajri përreth u ligështua më shumë. Qetësia që zotëroja kur plumbat rrihnin muret ishte herë më pak e ligshtë se ajo e mungesës së tyre. Me dukej sikur ajo zagushi heshtjeje ushqejej nga ngjyra e gjakut tim që me kohë ia kishte lënë shëndenë faqeve të mia.

- Atëherë përse ekzistojmë ne njerëzit? - e pyes unë pas një momenti qetësie, që jashtë atij bunkeri përkthehej në qindra të vdekur. - Cili është qëllimi?
- Mendoja se njeriu nuk kishte kohë të filozofonte në luftë.

Fytyra e tij mori hije serioze.

- E di se si ka evoluar universi?
- Jo.
- Sa keq. Po të kishim më shumë kohë do ta tregoja.
- Tregomë aq sa koha na premt.
- Ne jemi fryt i mjedisit në të cilin jetojmë, djalosh. Universi është pema, ne fruta. Kemi dalë prej tij, nuk na kanë vendosur në të. Universi është oqeani. Ne jemi dallga.
- Por kush e krijoi këtë oqean?
- Kjo është pyetje me kleçkë. Sepse nëse ia atribuojmë krijimin një qenieje mbinatyrore, atëherë, rrjedhimisht lind pyetja: po qenien mbinatyrore kush e ka krijuar? Dhe kjo vazhdon në regres të pafund. Fakti që nuk mund të faktosh diçka nuk të jep të drejtën ta mbushësh atë hapësirë me fantazitë e tua boshe, që shpesh herë bazohen në dëshira personale. Ja, pikërisht kështu lindin fetë. Por nuk do i futem kësaj teme. Koha jonë është e limituar dhe nuk do t'i harxhoj minutat e mia të fundit duke folur për fantazi. Gjithë ç'mund të them është se e gjitha varet te një pyetje e vetme: Përse? Nëse ti do e bëje këtë pyetje më shpesh, nëse ti do ishe më skeptik mbi gjërat që të kanë mësuar, atëherë do e kuptoje që gjithçka varet tek mundësia që ke pasur për informacione dhe se sa i ke kuptuar ato informacione. Në botën e shkencës hipoteza e Zotit nuk është e nevojshme, sepse një univers mund të lindë dhe pa ndihmën e tij. Është krejtësisht e mundur. Por që ta kuptosh këtë, duhet të kalosh kohë duke studiuar fizikë, astronomi, biologji e shumë degë të tjera të studimit të natyrës. Sigurisht që ka pyetje që nuk janë përgjigjur akoma, por kjo s'do të thotë oburra t'i mbushim me përgjigjet tona. Sepse, nëse shikon me vëmendje, ato përgjigje, përkojnë, në mënyrë çuditërisht rastësore, me dëshirat tona më të thella - që të ndahemi në të mirë dhe të këqij, ku e mira të bazohet në

mënyrën se si ne mendojmë për të mirën. Dhe si me magji linden ferri dhe parajsa. Por ti ke nevojë të mbash mend vetëm këtë gjë: ferri dhe parajsa janë diçka që i mbajmë me vete! Dhe jeta është tepër ironike për të mos na treguar shembuj që ta dëshmojmë këtë gjë. Ja, mirëserdhe në ferr!

Ti do një jetë të përtejme?! E di përse? Sepse kjo ku ndodhemi është kështu siç e sheh tani. Një ferr! Dhe kush e krijon këtë ferr? Njerëzit! Dëshirat e tyre! Pasionet e tyre të çmendura! Besimet e tyre. Këta të fundit kanë krijuar më shumë luftëra sesa mund ta imagjinosh. Më pyete përse ekzistojmë? Kush mban përgjegjësi për këtë që po bëjmë? Ne! Të vjetrit tanë. Fëmijët tanë. Njeriu është i vetmi përgjegjës për atë që i bën vetes dhe mjedisit ku jeton. Por, fatmirësisht, është po njeriu ai që e ka në dorë ta sjellë situatën nga ana tjetër e medaljes. Është po njeriu përgjegjës për lumturinë që i jep vetes dhe të tjerëve rreth tij. Njeriu është ferri dhe parajsa e vetes! Të përtejshmet janë veçse justifikim i dembelisë.

Isha mpirë në të gjithë trupin. Koka ziente nga mendime që lëviznin me shpejtësinë e plumbave. I panjohuri përballë meje u ngrit në këmbë të hidhte shikimin përtej hapësirës së vogël të bunkerit. Kush ishte vallë ky njeri? Sa po bëhesha gati ta pyesja, kur papritur një breshëri plumbash u bë njësh me betonin e strehës sonë. Trupi i mikut tim u dergj i pajetë në tokë. Brenda meje lindi një ndjesi përzierjeje. Volla në një cep dhe me kujdes u nisa për të gjetur një tjetër strehë. Përveç të vjellës sime mbrapa lashë dhe keqardhje. Dukej që kishte qenë mendje e ndritur. Por lufta nuk donte t'ia dinte për të tilla detaje. Lufta donte gjak. Dhe gjaku nuk kishte identitet. Nuk njihnte faj apo te pafajshëm. Lufta donte vetëm atë lëngun me ngjyrën e ferrit.

Pas disa manovrash që më shpëtuan kokën nga plumbat, u gjenda në një tjetër bunker. Ai ishte pak më i madh dhe brenda tij dy veta po luftonin, duke

hedhur bashkë më plumbat dhe sharje që dilnin nga thellësia e qenieve të tyre.

- Të poshtër! Horra! Në ferr do të shkoni! Në ferr! - bërtiste njëri.
- Vriti, vriti! - thërriste tjetri.

U afrova më shumë. Zhurma e hapave tërhoqi vëmendjen e njërit prej tyre, më kaloi një shikim të shpejtë nga koka tek këmbët dhe ktheu shikimin përsëri drejt armikut. Hodha sytë tek uniforma ime. E kisha të njëjtë si ata. Ndodhesha mes miqsh. Ose të paktën kështu mendoja.

- Kundër kujt po luftojmë? - pyeta.
- Çfarë?! Je gjë i prapambetur? - ma kthen njëri prej tyre. Kishte fytyrë të çeliktë.
- Jo, jo. Thjesht kam goditur kokën dhe ndihem pak i turbullt. Më duket se kam humbur kujtesën.

Tjetri, që po e ndiqte bisedën më cep të syrit, tha:

- E kam parë të ndodhë mjaft herë. Është pamja e gjakut. Ajo ta merr kujtesën, djalosh. Ajo ta ka marrë. Është e frikshme, ë?

Në zërin e tij fshihej krenari.

- Nëse e ke dëshmuar shpesh këtë gjë, nëse ajo shkakton të tilla efekte të tmerrshme, atëherë përse luftojmë?

Ajo që thashë që një bombë që nuk e prisnin.

- Ky nuk paska humbur kujtesën, - iu drejtua fytyra e çeliktë shokut të tij krenar. - Ky paska humbur fitilin. Ç'do të thuash me "përse luftojmë"? Luftojmë për të drejtën tonë. Luftojmë sepse ata e kanë gabim.

- Po ata përse luftojnë?

Dukej qartë që pyetjet e mia po i acararin më shumë se plumbat.

- Sepse janë të çmendur! Mendojnë se kanë të drejta mbi ne. Mendojnë se janë zotë të këtij vendi. Që feja e tyre është e vërteta. Që mendimet tona janë mendime injorantësh. Bijtë e kurvave!
- Ndërsa unë luftoj sepse më kanë vlarë familjen. Nuk më nevojitet asnjë arsye, asnjë e drejtë tjetër. Për ta do shkatërroj botën nëse duhet.

Fytyra e tij e çeliktë shfaqti pak ndryshk.

- Por, a nuk është e njëjta gjë dhe për...?

Pyetja m'u ndal në mes nga britma e njërit prej tyre.

- Mjaft me këto pyetje tani! Ose lufto me ne, ose shporru prej këtej me gjithë atë mendjen tënde të çalë.

Mes mundimesh arrita të gjej një tjetër strehë, këtë herë të boshatisur.

- Përse veprojnë ashtu? - mendova me vete. - Përse janë kaq të etur për luftë? Përse krijojnë ferr, kur shpresojnë për parajsë? Nuk e kuptojnë këtë gjë, ata të tjerët?

Duhet të gjeja përgjigje! Një mendim lindi aty për aty, por e mënjanova, duke e klasifikuar si të çmendur. Por pastaj u kujtova se isha duke ëndërruar dhe ndoshta kjo që arsyeja përse nuk isha zgjuar akoma; nuk dija përgjigjet e anës tjetër.

Mora frymë thellë dhe vrapova mes një fushe të mbushur me kufoma. U gjenda në anën tjetër, me frymën e marrë dhe uniformën e ndryshuar. Isha

nga ana e armikut. Kisha uniformën e tyre. Isha armiku. Duhet të zbuloja përse.

Bunkerët e tyre ishin të njëjtë me të anës tjetër. U nisa me vrap drejt atij që kisha më afër. Nga jashtë ai dukej i boshatisur. Por sapo kalova pragun, papritur ndjeva një shtrëngim të fortë pas qafe.

- Eja këtu, këlysh bushtre! Ku do të shkosh, ë? Çfarë do këtu?
- Hej, hej, jemi në të njëjtën anë, ngadalë! Shikoje uniformën.
- Oh, më fal. Të pashë që erdhe me vrap nga ana tjetër dhe mendova se je armik. Ç'dreqin doje andej, ë?

Mbërthimi u lehtësua dhe unë munda të marr frymë lirshëm. Mbështeti pushkën në mur dhe u ul përbri saj.

- Isha i infiltruar. Më dërguan të mësoja taktikat e tyre.
- Mësove gjë? U vodhe ndonjë sekret atyre të pafeve, ë? Mallkuar qofshin!
- Përse i urrejmë? Përse luftojmë kundër tyre?
- Ke goditur gjë kokën, djalosh?
- Po filloj të mendoj që po.
- Ndodh. Ose thjesht nuk mund ta durosh ngjyrën e gjakut. Ajo ngjyrë të çmend. E di mjaft mirë. Kështu u çmend dhe djali im, derisa ata e vranë. Të mallkuarit!
- Pra, ti lufton për hakmarrje?
- Sigurisht!
- Por në fillim, atëherë kur nuk kishe për çfarë të hakmerreshe, cila ishte arsyeja e luftës tënde?

Balli i tij u ngrit sipër për të krijuar ca rrudha mendimi.

- Të them të drejtën nuk e mbaj mend. Ka kohë. Por nuk më duhet gjë. Hakmarrja më mjafton. Të mallkuarit. Do t'i vras të gjithë.

E braktisa bunkerin, duke i premtuar se do t'i transmetoja sekretet e vjedhura tek eprorët tanë dhe u nisa në kërkim të luftëtarëve të tjerë. Ishin kudo. Të gjitha moshat. Të gjitha ngjyrat.

Në bunkerin e radhës gjeta dy burra, një më nofulla të gjëra, tjetri me fytyrën plot gjak.

- Të pamë që erdhe nga kampi i armikut, - foli nofullmadhi. - Duhet të jesh i infiltruar, apo jo? Zbulove gjë?
- Fatkeqësisht asgjë, - ia kthej unë, i lumtur që nuk ishin treguar mosbesues si i pari. - Përveç urrejtjes.
- Ah, bijtë e kurvave! Urrejtje, ë? As që ia kanë idenë me kë kanë të bëjnë, çfarë urrejtjeje kanë përballë!
- Përse i urrejmë?
- Ke goditur gjë kokën djalosh?
- Tri herë gjer tani.
- Kuptoj. Ndodh shpesh.
- Kështu kam dëgjuar dhe unë.
- Është pamja e gjakut. Ajo t'i merr mendtë, - u hodh i ngjyeri me gjak.
- Siç duket ti nuk e ke dhe aq problem.
- Nëse jeton me tmerrin tënd nuk ka gjë që të frikëson. Por është gjaku i atyre të mallkuarve andej që dua të kem në fytyrë!
- Por, përse jemi duke i luftuar?
- Ty gjaku të çmendka më duket. Sepse mendojnë që kanë të drejta mbi ne. Sepse na përgënjeshtrojnë besimet, mendojnë se besimet e tyre janë mbi të tonat. Të pabesët! Do të digjen në ferr për këtë!
- A nuk jemi në ferr tashmë?

- Oh, jo, jo. Duhet t'i vrasim në fillim që pastaj të shporren në dreq t'mallkuar! Në fund ne do të shpërblehemi me parajsë. E drejta duhet të fitojë!
- Po jetët e pafajshme? Fëmijët, gratë, pleqtë e tyre? Përse duhet të vdesin ata?
- Sepse ne jemi në anën e drejtë, ndërsa ata rastisën në anën e gabuar. Nuk është faji ynë. Tani, mjaft me pyetje. Kape atë pushkën atje dhe fillo të vrasësh ndonjë nga ata të mallkuarit. Jepi!

Nga larg sirenat filluan të kumbonin qiellin. Shpërthimet sa vente shtoheshin. Dridhja e tokës poshtë këmbëve po afrohej gjithë e më shumë. Në fillimin e një sekonde isha mbledhur me kokën mes gjunjëve, në fundin e tij nuk ndodhesha më aty. Përreth gjithçka u bë e zezë si nata. U riktheva në realitet duke dihatur me shpejtësinë e dikujt që nuk ia ka idenë se çfarë po ndodh. Preka ballin. Këtë herë djersa ishte e kuqe.

KREU 10

Baroni po më shihte nga banaku si i shastisur, ndoshta nga lëvizjet që mund të kisha bërë në gjumë, por nuk ia kisha ngenë dhe fort shpjegimeve. Dola nga kafeneja duke mirëpritur më ëndje ajrin e ftohtë të dhjetorit.

Mora rrugën për nga liqeni. Ishte e vetmja pamje që mund të më qetësonte sadopak. Në të djathtën time perëndimi kishte nisur të merrte formë. Nuk u desh shumë që liqeni të shfaqej para meje. E doja atë pjesë të natyrës! Pa fjalë. Pa mendime. Nuk ishte e thënë të shpjegoje përse liqeni ekzistonte. Liqeni thjesht ishte. Por pastaj, ashtu ishte edhe ajo.

Ai imazh i fundit diellor, që po arratisej drejt gjysmës tjetër të globit për të dëshmuar të tjera histori, nuk mund të ngulitej ndryshe në mendjen time veçse me kujtimin e largët të buzëve të saj, kur, të fshehur larg syve të botës, të mbërthyer në krahët e njëri-tjetrit, tymosnim të njëjtën cigare. Në një moment u ngrita dhe fika dritën. Nuk e di përse e bëra atë veprim. Ndoshta kisha nevojë të shikoja trupin e saj në errësirë.

I mora cigaren nga dora dhe po shikoja me vëmendje pjesën që digjej.

- E di, - i thashë unë. - Kur drita është e ndezur, askush nuk i jep rëndësi flakës së cigares. Por kur errësira troket në sy, ajo dritë e vogël bëhet udhërrëfyese në verbërinë e shqisave. Si zemra.

Fjalët më dolën instinktivisht, si çdo veprim kur ndodhesha afër saj.

Ajo që thashë e eksitoi më shumë dhe më tërhoqi drejt vetes me vull të ëmbël. Ishim aq afër, sa nëse ulja sytë mund të shihja të kuqërremtën e buzëve që kafshoheshin me njëra-tjetrën. Tymi që dilte nga hapësirat e vogla të kafshimit vraponte drejt flakës së cigares dhe gjatë atij udhëtimi të shkurtër nga buzët e saj te sytë e mi, në ajrin mes nesh krijoheshin piktura.

Në fillim pikturoheshin rrathë. Pastaj siluetat e trupave tanë. Në fund bashkimi i buzëve, shoqëruar me rënkimin e zakonshëm të të dashuruarve kur duan të dhurojnë gjithçka me një puthje të vetme.

Me sytë lart, duke u munduar të krijonim imazhe të ndryshme në ndërthurjen e gishtave tanë, ajo më pyet përse e dashuroj. Ma kishte bërë çdo ditë atë pyetje e përsëri më dukej sikur ishte hera e parë.

- Kam frikë nga flaka, e dashur, - pëshpërita. - Por më duhet ta përqafoj si udhërrëfyesen time të vetme kur bie errësira. E njëjta gjë dhe me ty. Të jetoj që të krijoj veten nga fillimi është diçka që gjithmonë kam dashur ta bëj. Por pastaj të njoha ty dhe kuptova se qenia njerëzore nuk është lindur të sillet e vetme nën këtë qiell të pafund. Është rrugë e vështirë të nisem në kërkim të vetes, por kur të pashë ty kuptova se më e vështirë është të nisesh i vetëm. Unë jam si cigarja. Digjem sepse është rruga e vetme që tymi yt të dalë nga zjarri brenda meje. Të dua, sepse qëkur ndalova kërkimin e të vërtetës sime, kuptova se dashuria është e vërteta e të gjithëve, dhe ti vetëm imja.
- Më puth! - pëshpëriti ajo dhe u ngjit sipër meje. Menjëherë, cigarja u tret në hi dashurie.

Me hapin e hedhur drejt një stoli aty afër mbaroi dhe ajo retrospektivë. Sapo imazhet e kujtuara ranë përsëri në fund të harresës, u ngrita dhe lejova këmbët të më drejtonin nga të donin. Isha i rraskapitur. Nuk mbaja mend kur kisha ngrënë për herë të fundit. Plogështia më kishte zaptuar çdo muskul. Përpara meje, në sheshin e një katedraleje të vjetër po luanin ca fëmijë. Më kujtuan fëmijërinë, larg atij vendi dhe asaj kohe, larg çdo mendimi dhe kujtimi, larg në vendet e patrazuara të pafajshmërisë.

Ndodhesha mes përpjekjes për të ndaluar kujtimet dhe kundrimin e lojës së fëmijëve, kur, papritur, cepi i syrit dalloi nga larg një siluetë burri që po përkulej tej parmakut së shinave të trenit, mu përbri katedrales. Me t'u qartësuar vranësira, pa e ditur pse, u nisa drejt tij.

Ishte veshur me sqimë. Kostum serioz prej atyre të shtrenjtëve, çantë lëkure të kadifenjtë, orë të shtrenjtë ari. Por ndryshe nga çfarë tregonte veshja, në sytë e tij mund të dëshmoje fare pak jetë. Ngjyra e tyre ishte venitur. Nuk kishte shkëlqim në atë shikim.

- Më paska mbetur dhe një cigare në paketë, - i them, duke ngritur zërin, me shpresën se do t'ia fitoja vëmendjen. Ai nuk lëvizi.
- Kemi një shprehje andej nga anët e mia, - vazhdova. - “Cigarja e fundit nuk i jepet askujt”. Por meqë unë s'dua t'ia di për besëtytni, ja, urdhëro!

Shikimi i tij u var mbi dorën time të zgjatur.

- Mos ma prish qejfin, - këmbëngula, duke zgjatur dorën dhe më shumë. Ai, me entuziazëm të errët, mori cigaren dhe e vendosi mbi buzët e thata.

Kaluan dy minuta. E vetmja gjë me të cilën merrej heshtja ishte tymi që sillej në ajër pa ndonjë formë të veçantë. Pikërisht në të tilla çaste lindte brenda kokës sime pyetja kaq shumë e përsëritur: ç'kuptim kishte gjithçka?

Shkunda dorën në ajër, më shumë të hiqja tutje mendimin sesa tymin që po kthehej drejt fytyrës sime, dhe u solla nga i panjohuri.

- Pret ndonjë tren?
- Pritet gjë tjetër këtu? - Zakonisht, të tilla përgjigje zhyteshin në ironi, por në timbrin e zërit të tij dëgjoja vetëm vdekje.

- Sigurisht që jo, por rëndësi ka ajo çfarë ndodh kur treni vjen, apo jo? - Fytyra ime mori formë pikëpyetjeje.
- Treni i vdekjes është gjithmonë i përpiktë! - tha ai duke bërë me kokë drejt kthesës së largët. Papritur, një tren shpoi pëlhurën e errësirës, tutje në kufirin e horizonteve tona. Spazma drithërimash përshkuan trupin tim. Hodha sytë drejt tij. Hija kishte pushtuar trupin. Jeta i qe arratisur. Nuk kishte mbetur më ç'të vdiste.

Treni erdhi, kaloi dhe u largua tutje frymës sime, që doli më e çliruar se asnjëherë.

- Si quhesh? - e pyes.

Asnjë përgjigje.

Dora ime e zgjatur nuk takoi gjë tjetër veç shikimit të tij. Papritur, u kthye nga kishte thembrat dhe u nis drejt disa shkallëve, pak më tej nesh.

- Shpresoj të mos takohemi më, - thirra unë. - Këtu! Këtu, e kisha fjalën! - shtova në fund, por një tjetër tren kaloi me shpejtësi dhe fjalët u shuan aty për aty.

Mbërrita tek kafeneja më shpejt seç e mendova. Baroni po pastronte ca filxhanë. Po ushtronte kaq shumë forcë mbi qelqin sa më dukej se do e thyente. Më përshëndeti me të qeshurën e tij të përhershme dhe më ftoi të ulesha në banak.

Gjatë kohës që përgatiste kafënë, në mendje më erdhi pyetja që kisha dashur t'i bëja.

- Hej, Baron, përse punon banakier ti?

Ai ngriti sytë i habitur.

- Ndoshta sepse kam nevojë për pará?!
- E di shumë mirë përse e kam fjalën.
- E paske gjetur maskën tënde publike më në fund?
- Ndoshta. S'e di.
- E tillë është dhe përgjigja ime.
- S'po të kuptoj.
- Të kam thënë para ca ditëve, nëse e mban mend, se disa gjëra, edhe pse duken të pakuptimta në sytë e të tjerëve, vijnë si pasojë e një luftë të gjatë me përbindëshin brenda nesh. Kjo është mënyra se si unë përballem me të.
- Dhe ti do të bësh pikërisht këtë gjë?
- E çuditshme, ë? Për ty ama. Jo për mua.

Ndenjëm disa minuta pa folur. Pastaj Baroni prishi heshtjen.

- E flake tutje?
- Kë?
- Maskën pra, personin tënd publik.
- As këtë s'e di akoma. Si flaket?
- Thjesht duke mos qenë ai.
- Do të përpiqem, por në fillim më duhet të çlirohem pak. - Dhe duke qeshur u nisa drejt banjës.

E qeshura u shtua dhe më, kur në paradhomën e tualetit, aty ku bëhej ndarja e meshkujve dhe femrave, u gjenda përpara një pasqyre. E kisha parë veten me dhjetëra herë në atë pasqyrë, por, për çudi, këtë radhë m'u duk sikur ishte hera e parë. Persona nuk e shikonte më shkarazi reflektimin e tij në pasqyrë. Persona ndodhej lakuriq përpara vetes.